



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

### V E N D I M

Nr. 81, Datë 31.03.2021

#### PËR CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ PROKURORIT BUJAR MEMIA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 148/d, pika 2 germa "a", 149/a pika 1 germa "b", 179 pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 146, 148 pika 2 germa "c", 149 pika 1, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve", i ndryshuar, nenet 184 germa "e", 189 pika 1, germa "a", 192 paragrafi 1 fjalia e dytë, të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, nenin 104 të Kodit të Procedurës Administrative së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin Nr.260, datë 17.11.2020 të KLP-së, shqyrtoi kërkesën për procedim disiplinor nr Nr.104 prot., datë 15.01.2021që i përket;

#### KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani

#### SUBJEKTI I PROCEDIMIT

**Z. Bujar Memia**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Krujë, përfaqësuar me prokurë nga av. Fatmir Braka dhe av. Anteo Papa.

#### OBJEKTI:

Fillimi i Procedimit Disiplinor ndaj magjistratit **Bujar Memia**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

#### BAZA LIGJORE:

Neni 148/d, pika 2, shkronja "a" dhe "b", Neni 149/a, pika 1, germa "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e neneve 142 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoji:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Z.Artur Metani**, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1 shkronjat “ç”, “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

- **Magjistratin Bujar Memia**, i cili përfundimisht kërkoi rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor ndaj tij, për shkakun se faktet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është administruar kërkesa me Nr.104 prot., datë 15.01.2021, “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë”, ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shoqëruar me Raportin për hetimin disiplinor nr.1752/21 prot., datë 14.01.2021 dhe dosjen hetimore për zhvillimin e procedurës disiplinore nga Këshilli në ngarkim të këtij magjistrati duke i propozuar Këshillit:

- i. *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1 shkronjat “ç”, “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe*
- ii. *Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1 shkronjat “ç”, “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;*

2. Në mbështetje të nenit 120, pika 1 dhe nenit 122, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>1</sup>, të ndryshuar me Vendimin Nr. 1170 prot, datë 15.06.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur verifikimi i fakteve të bëra publike në median elektronike, në lidhje vrasjen e shtetasit (H.B), ndodhur me datë 12.06.2020. Në informacionin e bërë publik në media, janë prezantuar disa fakte në lidhje me dënimin e këtij shtetasi me burgim të përjetshëm nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, si dhe njohja e këtyre vendimeve nga ana e autoriteteve gjyqësore shqiptare si dhe në të njëjtën kohë, janë publikuar fakte lidhur mbi disa vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, të dhëna gjatë kohës që shtetasi H.B vuante dënimin pranë I.E.V.P. Fushë-Krujë duke u finalizuar lirimi para kohe i tij. Në media është bërë publik gjithashtu edhe fakti se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë janë marrë disa vendime lidhur me lirimin para kohe me kusht edhe për të dënuar të tjerë si (I.P) apo (E.D. Në kuadër të verifikimit të këtyre rrethanave, ILD ka vendosur marrjen e të dhënave shtesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë apo gjykatave të tjera lidhur me proceset gjyqësore të zhvilluara për sa i përket të dënuarve H.B dhe I.P.

3. Në përfundim të procesit të verifikimit të këtyre informacioneve, me vendimin nr. 1752, datë 16.07.2020, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj prokurorit Bujar Memia, në përfundim të të cilit është përcjellë pranë KLP-së kërkesa e shoqëruar me dosjen hetimore për procedim disiplinor.

4. Hetimi disiplinor ndaj prokurorit Bujar Memia, është zhvilluar në lidhje me 4 vendime të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ku prokurori Bujar Memia ka përfaqësuar organin e akuzës dhe konkretisht :

- (i) Vendimin nr. 65 akti, datë 06.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
- (ii) Vendimin nr. 82 akti, datë 14.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
- (iii) Vendimin nr. 463 akti, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
- (iv) Vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

5. Në lidhje Vendimin nr. 65 akti, datë 06.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ku është vendosur aplikimi i dënimit alternativ “Qëndrim në shtëpi” për kërkuesin I.P, për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 vit 8 muaj dhe 9 ditë burgim, duke e vënë në provë për një periudhë kohore prej 1 vit dhe 8 muaj. Sipas raportit hetimor, rezulton se dhënia e këtij vendimi është bërë sipas nenit 59/a, paragrafi 1, shkronja “c” të Kodit Penal për “qëndrimin në shtëpi” të të dënuarit I.P, për shkak të kushteve të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor jashtë burgut, pa marrë një provë vendimtare në lidhje me objektin e shqyrtimit gjyqësor sikundërse është akti i ekspertimit mjeko-ligjor. Qëndrimi i prokurorit Bujar Memia në seancë në ushtrim të funksioneve të veta, roli i tij apo pyetjet e shtruara mjekut, mosparaqitja e kërkesave procedurale për marrjen e një prove vendimtare për zgjidhjen e çështjes të parashtruar për shqyrtim sipas parashikimeve të neneve 178, 182 dhe 366 të K.Pr.Penale, konkretisht akti i ekspertimit mjeko - ligjor, nuk kanë qenë ezauruese në drejtim të hetimit gjyqësor mbi plotësimin e kushteve të kërkuara nga neni 59/a, pika 1, shkronja “c” e Kodit Penal, për të disponuar gjykata ndaj kërkesës së të dënuarit I.P.

6. Është konstatuar se as gjykata nuk është investuar kryesisht për marrjen e një prove vendimtare, për zgjidhjen e çështjes të parashtruar për shqyrtim, për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit, dhe për të vlerësuar më pas, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 59/a, pika 1, shkronja “c” të Kodit Penal. Pavarësisht këtij fakti, konstatohet gjithashtu se nga ana e prokurorit

<sup>1</sup> Në vijim Ligji për Statusin



Bujar Memia nuk është ushtruar ankim ndaj vendimit me nr. akti 65, datë 06.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me pasojë marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor për aplikimin e alternativës së dënimit me burgim “Qëndrimin në shtëpi” parashikuar nga neni 59/a, paragrafi 1, shkronja “c” e Kodit Penal, në favor të të dënuarit I.P, pa u krijuar mundësia e kontrollit gjyqësor të kësaj vendimmarrje lidhur me provueshmërinë e kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

7. Drejtuesi i prokurorisë më datë 17.11.2017 ka nxjerrë udhëzim jodetyrues për prokurorin Bujar Memia për ankimin e këtij vendimi me argumentin se nuk është marrë prova me ekspert mjekoligjor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit I.P. Nga ana e prokurorit Bujar Memia.

8. I dënuari I.P ka paraqitur fillimisht në datën 07.10.2016 kërkesën penale me objekt “Lirim për shkak sëmundje” parashikuar nga neni 478 të K.Pr.Penale, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtarës E.T.,. Gjyqtarja ka marrë vendim për caktimin e një grupi ekspertësh nga I.M.L-ja. Në vijim të gjykimit është paraqitur kërkesë e të dënuarit për përjashtim të gjyqtarës nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin e datës 23.01.2017. Në vazhdim i dënuari ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, mbi bazën e të cilës gjyqtarja E.T., ka disponuar me vendimin nr. 8/54 akti, datë 08.02.2017.

9. Gjithashtu ka rezultuar se i dënuari I.P ka paraqitur më datë 17.07.2017 kërkesën penale me objekt “Aplikim dënimi alternative, qëndrim në shtëpi” regjistruar me nr. 63 akti, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtarës E.T.

10. Më datë 25.07.2017, i dënuari Ilir Paja, me emrin Lir Pajo ka paraqitur kërkesën penale me nr. 65 akti me objekt: “Qëndrim në shtëpi”, e cila pas shortit elektronik (emri i kërkuesit është pasqyruar i ndryshëm), i ka kaluar për shqyrtim magjstrates nën hetim disiplinor E.H. Pra i dënuari de facto, ka pasur dy gjykime me të njëjtin objekt tek dy gjyqtare të ndryshme të së njëjtës gjykatë, ndërsa prokurori Bujar Memia ka qenë i pranishëm vetëm në gjykimin e çështjes me nr. 65 akti, datë vendimi 06.11.2017.

11. Në lidhje me këtë çështje prokurori Bujar Memia, ka parashtruar se është caktuar si prokuror në këtë çështje gjyqësore dhe ka përfaqësuar organin e akuzës Krujë vetëm në seancat e datës 03.11.2017 dhe të datës 06.11.2017, pavarësisht se, çështja është regjistruar në datë 25.07.2017 dhe se në momentin që ai ka përfaqësuar organin e akuzës ishte kaluar momenti procedural i parashikuar nga neni 356 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: “Prokurori parashtron në mënyrë të përmbledhur faktet objekt akuze dhe tregon provat, që kërkon të shqyrtohen” dhe se në këtë moment procedural lejohet marrja e provave, që nuk janë kërkuar paraprakisht kur pala, që i kërkon pretendon se nuk ka pasur mundësi t’i kërkonte. Magjistrati nën hetim pretendon se, ai është bërë pjesë e procesit gjyqësor, pasi ishte tejkualuar momenti procedural kur mund të kërkonte marrjen e provës me ekspert. Gjithashtu ai thekson se, konkluzionet e I.L.D-së janë një keqinterpretim flagrant i ligjit procedural penal, kur argumentojnë se, veprimtaria e tij nuk plotëson kriteret e nenit 178, 182 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale, pasi dispozita ku organi hetimor mbështet paligjshmërinë e veprimeve të magjistratit është neni 178 i Kodit të Procedurës Penale, i aplikueshëm nga ana e prokurorit në momentin e hetimeve paraprake dhe jo në momentin që çështja është dërguar për gjykim, aplikimi i të cilës është ekskluziviteti i gjykatës. Gjithashtu magjistrati nën hetim pretendon se, neni 366 i Kodit të Procedurës Penale i referuar nga I.L.D nuk mund të kërkohet nga palët, përveçse nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 356 i Kodit të Procedurës Penale, pra që kërkesa të bëhet në fazën e parashtrimeve dhe kërkesave për marrje provash ose në rast se pala provon se nuk ka pasur mundësi efektive të paraqesë apo kërkojë administrimin e një prove të tillë.

12. Më tej në shpjegimet e tij, magjistrati nën hetim thekson faktin se, të dënuarit I.P. i kishte mbetur vetëm një periudhë prej 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj për vuajtjen e dënimit total të caktuar ndaj tij dhe në bindjen e tij ai plotësonte kriteret e sanksionuara nga ligjvënësi për të aplikuar ndaj tij parashikimet e nenit 59/a të Kodit Penal, ku si provë për të përcaktuar nëse jemi përpara shkronjës “c” të nenit 59/a të Kodit Penal, kanë shërbyer kartelat klinike të të dënuarve, dokumente të tjera shëndetësore dhe pyetja e përgjegjësit të sektorit shëndetësor pranë I.E.V.P Krujë. Në mbështetje të këtij parashtrimi magjistrati ka paraqitur si provë dy vendime; vendimin nr. 140 rregj themeltar, datë 20.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lënë në fuqi me vendimin nr. 972, datë 13.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërsa me vendimin nr. 2420, datë 17.09.2015, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga prokurori dhe vendimin nr. 16/185 akti, datë 16.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

13. Magjistrati subjekt procedimi ka parashtruar se ai ka vepruar në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, duke u udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe pa anshmërisë. Bindja e tij ka qenë e drejtë dhe e saktë, pasi i dënuari nuk rezulton të ketë kryer asnjë vepër penale apo paligjshmëri nga momenti i lirimit të tij apo gjatë gjithë periudhës kur ai ka qenë subjekt i lirimit të kushtëzuar.

14. Lidhur me konstatimin për mos ushtrim të ankimit, prokurori thekson se, nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë nga ana e tij është çmuar se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me objekt “*Qëndrimin në shtëpi të I.P.*” është vënë në ekzekutim të menjëhershëm, duke bërë që trajtimi mjekësor të vazhdojë jashtë ambienteve të burgimit. Nga ana tjetër sipas prokurorit potencialisht e mundshme mund të ishte fakti që ekzekutimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë për afatin 1 vit e 8 (tetë) muaj do kishte përfunduar, para se të përfundonte gjykimit në Apel, çka do të thotë se, ankimimi do të ishte formal, pa formuar asnjë pasojë juridike. Në mbështetje të këtij pretendimi prokurori ka sjellë në cilësinë e provës ankimimin kundër të dënuarit G.T., i paraqitur si provë, ankim i cili deri në atë moment nuk ishte shqyrtuar ende në Gjykatën e Apelit.

15. Sipas prokurorit, ankimi ndaj vendimit të gjykatës është mjet procedural penal në trajtën e një pushteti diskrecional, pra ankimi është e drejtë dhe jo detyrim dhe sipas tij prova, që duhet të merret në këto lloj gjykimesh, për sa i përket shkronjës “c” të nenit 59 të Kodit Penal është marrja e dëshmisë nga institucioni mjekësor i I.E.V.P-së, që ofron shërbimin shëndetësor. Gjithashtu magjistrati nën hetim thekson se, duke qenë se, nga Shërbimi i Provës është përpiluar Raporti përfundimtar për përmbajtjen e vendimit të gjykatës dhe pas kohës së përmbushjes së ekzekutimit të këtij vendimi konstatohet se, ky i dënuar jo vetëm në kohën e provës, por edhe pas saj nuk është përfshirë në ndonjë veprimtari kriminale, fakt ky që të shpie në përfundimin se agjencitë ligjzbatuese kanë dhënë rekomandim të saktë lidhur me aplikimin e nenit 59/a të Kodit Penal.

16. Në lidhje me udhëzimin jodetyrues nga ana e prokurorit, në parashtrimet e paraqitura gjatë fazës hetimore nuk është dhënë asnjë shpjegim, apo shfaqje qëndrimi në lidhje me këtë udhëzim jodetyrues të drejtuesit të prokurorisë, por ka dhënë shpjegime në seancë dëgjimore dhe në parashtrimet e paraqitura pranë Këshillit, duke shprehur faktin se njoftimi i udhëzimit jodetyrues të drejtuesit të prokurorisë, i është njoftuar pasi kishte kaluar afati i ankimit.

17. **Në lidhje me vendimin nr. 82 akti, datë 14.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është vendosur** njohja e ditëve të paraburgimit të të dënuarit nga data e arrestimit të tij nga autoritetet angleze me datë 15.11.2007, deri kur vendimi i gjykatës së apelit Tiranë ka marrë formë të prerë më datë 20.07.2016. Gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar me prani të përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia i pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara.

18. Rezulton se me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur: “Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, i dënuar për veprat penale: vrasje; vrasje mbetur në tentativë dy herë; plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76 i K.Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim, për veprën penale të “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të K.Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim, për veprën penale të “Plagosje e rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të K.Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit H.B me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007.” Ky vendim ka ndryshuar vendimin nr.23, datë 13.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte vendosur dënimin e të pandehurit H.B me burgim të përjetshëm.

19. Me urdhrin e prokurorit të ekzekutimit të prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 07.09.2016 është kryer përlllogaritja e kohës së paraburgimit sipas nenit 57 të K.Penal dhe ajo e dënimit me burgim të vuajtur nga i dënuari në shtetin e huaj duke përcaktuar se nga dita e ekstradimit në Shqipëri datë 26.01.2016 e në vazhdim i mbeteshin për të kryer edhe 16 vjet 4 muaj dhe 3 ditë burgim.

20. Ndërkohë, pavarësisht përlllogaritjes së kohës së paraburgimit të kryer nga prokurori i ekzekutimit të prokurorisë së rrethit Tiranë, gjykata i ka rinjohur të dënuarit H.B., kohën e burgimit në shtetin e huaj si kohë paraburgimi deri në dhënien e vendimit të njohjes së vendimit të huaj nga gjykatat shqiptare, në kundërshtim me parashikimet e 57, të Kodit Penal; nenit 438, 518, pika 1 dhe neni 3, të Kodit të Procedurës Penale; neni 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”; neni 52, paragrafi 2, të Ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 154/2000. Prokurori Bujar Memia me qëndrimin e tij gjatë seancës gjyqësore nuk ka shfaqur asnjë kundërshtim dhe qëndrimi i tij i shfaqur në seancë ka qenë për pranimin e kërkesës.

21. Nga hetimi disiplinor konstatohet gjithashtu se pavarësisht disponimit të gjykatës, prokurori nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 82, datë 14.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke mos përmbushur në mënyrë të pajustificuar funksionet e veta gjatë gjykimit si dhe ka sjellë përfitim të padrejtë të të dënuarit në kundërshtim me nenet 518, paragrafi 1 dhe 3 të K.Pr.Penale, nenet 9, 10, 22 dhe 53 të Ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, neni 9/3 të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse”*, shkelje të dispozitës procedurale penale të nenit 518/1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit: *“1. Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar. 3 Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj llogaritet për efektet e ekzekutimit”*, neni 57 të Kodit Penal dhe 417 të K.Pr.Penale, neni 52 /2 i Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar, **në një kohë që urdhri i ekzekutimit të datës 07.09.2016 është i qartë.**

22. Në lidhje me këtë çështje prokurori ka parashtruar se i dënuari H.B është ndaluar nga autoritetet daneze në datë 04 Shtator 2007 dhe është transferuar në Mbretërinë e Bashkuar në datë 14 Nëntor 2007 dhe nga kjo datë e në vijim deri në transferimin e tij në Republikën e Shqipërisë ai ka qenë i burgosur në Mbretërinë e Bashkuar. Ky i dënuar është transferuar në I.E.V.P Fushë-Krujë në datë 26.01.2016, ndërkohë që më datë 20.07.2016 është dënuar me vendim të formës së

prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Sipas subjektit nën hetim i dënuari H.B, në momentin që është transferuar në burgun e Fushë-Krujës ka pasur cilësinë e të paraburgosurit, bazuar në një masë sigurimi të përcaktuar nga autoritetet britanike në vitin 2007, fakt i konstatuar edhe nga gjykata shqiptare, e cila me vendimin nr. 217/2017 referon se, vendimi i dënimit për H.B ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vetëm pasi këtij momenti ai ka fituar cilësinë e të dënuarit.

23. Prokurori Bujar Memia ka parashtruar se vendimi i formës së prerë të gjykatave shqiptare arrihet vetëm pasi të verifikohet plotësimi i përputhshmërisë ligjore të dënimit të dhënë në vendin e huaj me legjislacionin shqiptar, kjo për faktin se neni 516 i Kodit të Procedurës Penale detyron gjykatën vendase shqiptare që të konvertojë dënimin e caktuar nga një gjykatë e huaj, kjo me qëllim mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, të cilët mund të jenë subjekt i aplikimit të dënimeve më të rënda në shtetet e huaja. Cilësia e të dënuarit për H.B, fitohet me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nisur nga ky fakt, ligji shqiptar dhe praktika gjyqësore është tepër eksplicite në atë që konsiderohet vendim i formës së prerë dhe qartazi parashikon këtë moment si fillimin e përlogaritjes së vuajtjes së dënimit si i dënuar. Pra ky është momenti i ndryshimit të cilësisë së subjektit të veprës penale nga i paraburgosur në të dënuar. Në këto kushte, sipas magjistratit nën hetim kërkesa e të dënuarit H.B për të kërkuar njohjen e periudhës së ditëve të paraburgimit nga data e ndalimit deri në datën, që ai është dënuar me vendim të formës së prerë sipas ligjit shqiptar është një periudhë që ai e ka vuajtur burgimin, në cilësinë e të paraburgosurit dhe jo si i dënuar me vendim të formës së prerë.

24. **Në lidhje me vendimin nr. 463 akti, datë 21.11.2018** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për të dënuarin H.B., “Për njohje amnistie”, gjykata ka vendosur, pranimin e kërkesës së kërkuesit H.B, njohjen e amnistisë për kërkuesin H.B duke i ulur 1 vit nga dënimi, sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”... Gjykimi është zhvilluar me prani të përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia i pranishëm në 3 seanca e fundit gjyqësore, në datat 04.10.2018, 14.11.2018 dhe 21.11.2018. Ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 06.12.2018, pa u ankimuar nga prokurori.

25. Rezulton se me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur: “Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, i dënuar për veprat penale: vrasje; vrasje mbetur në tentativë dy herë; plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor; vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76, i K.Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim; “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të K.Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim; “Plagosje e rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të K.Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit H.B me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007.”

26. Veprat penale të parashikuara nga legjislacioni penal shqiptar për të cilat H.B është dënuar, konkretisht ajo e “Vrasjes” “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe “Plagosje e rëndë me dashje”, të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të K.Penal, kategorizohen si ndaluese për përfitim amnistie, referuar kriterit ndalues të parashikuar në nenin 4/b dhe 4/c të ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë” sipas të cilit: *“Pavarësisht nga përcaktimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për: b) krime kundër jetës, të kryera me dashje të parashikuara në nenet 76...[...].c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit të parashikuara nga nenet [...].88 ..[...]... të Kodit Penal”*. Vendimi është dhënë në shkelje të parashikimeve të nenit 5 të këtij ligji i cili parashikon shprehimisht se: *“Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë*



*nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra”.*

27. Sipas raportit hetimor të ILD-së vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 është marrë në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor pasi nuk rezulton që i dënuari H.B të plotësonte kushtin e parashikuar në ligj. Në kohën e dhënies së vendimit nuk rezulton që këtij të dënuari t'i kishte mbetur pa vuajtur 1 vit nga dënimi i dhënë me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 prej 25 vite burgim. Në kohën që gjykata, në prani të prokurorit nën hetim disiplinor Bujar Memia ka disponuar për lirimin e të dënuarit H.B me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 (*pas disa muajsh nga dhënia e vendimit nr. 463/2018*) sipas dispozitivit të vendimit, të dënuarit H.B i kishin mbetur pavuajtur nga dënimi dhe 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë.

28. Konstatohet se prokurori Bujar Memia nëpërmjet qëndrimit në seancë dhe mos ushtrimit të ankimit ndaj vendimit nuk ka përmbushur funksionet e parashikuara në nenin 24 të K.Pr.Penale si mbikëqyrës i ekzekutimeve të vendimeve penale. Këtë gjë ka bërë në mënyrë të pajustificuar gjatë gjykimit duke sjellë përfitimin e padrejtë për të dënuarin referuar kriterit ndalues të parashikuar në nenin 4/b dhe 4/c të Ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”, sipas të cilit “*Pavarësisht nga përcaktimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për: b) krime kundër jetës, të kryera me dashje të parashikuara në nenet 76...[...].c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit të parashikuara nga nenet ...88 ...të Kodit Penal*”. Rezulton se H.B me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë është dënuar pikërisht për veprat penale të cilat kategorizohen si ndaluese për përfitim amnistie: “Vrasjes”; “Vrasjes së mbetur në tentativë”; dhe “Plagosje e rëndë me dashje”; të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të K.Penal, dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55, të K.Penal është dënuar me 25 vite burgim. Ky vendimi nuk rezulton të jetë ankimuar dhe për pasojë ka marrë formë të prerë.

29. Lidhur me vendimin nr. 463 akti, datë 04.07.2018 për të dënuarin H.B., “*Për njohje amnistie*” magjistrati nën hetim disiplinor parashtron se kjo qasje e I.L.D-së është në kundërshtim me vetë frymën që ka parashikuar neni 4/b dhe neni 5/1/b i Ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”. Sipas këtyre dispozitave ligji ka amnistuar kategorinë e të dënuarve, të cilëve u ka mbetur edhe një vit burgim i pavuajtur. Ky kriter ligjor, duhet zbatuar edhe për rrethin e të dënuarve të tjerë, të cilët nuk mund të lirohen, por nga ana tjetër janë subjekte, që përfitojnë uljen me 1 (një) vit burgim. Parë në këtë këndvështrim sipas ankuesit, i dënuari H.B përfitonte nga ulja e dënimit, pasi pavarësisht ndalimit të parashikuar në nenin 4 të ligjit, ai do të përfitonte plotësisht nga amnistia nëse do të kishte vetëm një vit të mbetur nga vuajtja e dënimit total. Një arsyetim i tillë sipas subjektit nën hetim i ka krijuar atij bindjen se, i dënuari është subjekt i përfitimit të këtij ligji dhe se nuk ekziston domosdoshmëria që ky vendim të ankimohet, bindje e plotë e magjistratit nisur nga praktikat e ngjashme, por edhe nga interpretimi që i është bërë në vazhdimësi ligjit për amnistinë. Në mbështetje të një pretendimi të tillë, prokurori ka paraqitur si provë: (i) Vendimin nr. 940 akti, datë 05.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) Vendimin nr.157 akti, datë 11.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) Vendimin nr.79, datë 25.05.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

30. **Në lidhje me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019**, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë “*Për lirimin me kusht*” të të dënuarit H.B, ku në përfundim Gjykata ka vendosur; Pranimin e kërkesës së kërkuarit (të dënuarit) H.B; lirimin me kusht të kërkuarit (të dënuarit) H.B, për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë, për një kohë prove prej 5 vjetësh, në zbatim të nenit 60 pika 1 e Kodit Penal i dënuari H.B të ushtrojë një veprimtari profesionale referuar kontratës së punës pranë personit fizik, ..... Gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar me prani të përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia, i pranishëm në të gjitha seancat





gjyqësore të zhvilluara për këtë çështje gjyqësore. Konstatohet se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 11.03.2019.

**31.** Nga raporti hetimor është konstatuar se vendimi është dhënë në mosrespektim të rëndë të nenit 64, paragrafi 1, ndarja e tretë të Kodit Penal për shkak të mosplotësimit të kushtit parësor për të përfituar lirim me kusht, ai i periudhës efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari H.B prej  $\frac{3}{4}$  si dhe, shkeljen e kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 2, i Kodit Penal, i cili parashikon se: “Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje”.. Nga provat e administruar, të tilla si dinamika e vuajtjes së dënimit me nr. ekstra prot., datë 24.01.2019 të ndodhur në dosje, rezulton se i dënuari H.B me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë është dënuar me 25 vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të K.Penal. Gjykata në vendim ka arsyetuar se duke ju referuar kësaj dinamike, i dënuari ka vuajtur gjithsej 19 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë burgim, dhe i mbeten për të vuajtur 5 vjet, 6 muaj dhe 11 ditë burgim. Konstatohet se  $\frac{3}{4}$  e dënimit prej 25 vite burgim për këtë kategori të dënuarish, rezulton të jetë 18 vjet dhe 9 muaj, ndërsa  $\frac{1}{4}$  rezulton të jetë 6 vjet dhe 3 muaj.

**32.** I dënuari H.B me vendimin me nr. akti 463, datë 21.11.2018, të cituar më lart në Relacion, të dhënë nga e njëjta gjykatë dhe në prani po të të njëjtit prokuror Bujar Memia, ka përfituar 1 vit ulje me amnisti sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”. Nëse edhe kjo periudhë nuk i është mbajtur në konsideratë sërish i dënuari nuk ka kryer kohën e përcaktuar në ligj për të kërkuar lirim me kusht, pasi në mungesë të saj ai ka kryer 18 vjet 5 muaj dhe 19 ditë burgim, kur në fakt duhej të kishte kryer 18 vjet dhe 9 muaj burgim. Pra konstatohet se në vuajtjen e dënimit gjyqtarja i ka llogaritur edhe kohën e përfituar me amnisti në shkelje të kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 2, i Kodit Penal.

**33.** Nga faktet e konstatuara gjatë hetimit, rezulton se prokurori Bujar Memia nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij Vendimit nr. 26 akti, datë 22.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke marrë formë të prerë, në një kohë që i dënuari H.B nuk plotësonte kushtin parësor për të përfituar lirim me kusht, ai i periudhës efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari H.B prej  $\frac{3}{4}$ , ndërsa rezulton se në kohën totale të dënimit është llogaritur edhe koha e përfituar me amnisti sipas ligjit nr. 141/2016, në kundërshtim me kriterin ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 2, i Kodit Penal i cili parashikon shprehimisht se: “Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje”. Pavarësisht kësaj, prokurori Bujar Memia, sërish nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit duke sjellë marrjen formë të prerë të tij dhe lirimin e të dënuarit në kundërshtim me ligjin.

**34.** Referuar të dhënave të administruara sipas raportit hetimor, konstatohet se nuk është zbatuar parashikimi i nenit 64 të K.Penal, mbi arsyet e veçanta për të përfituar lirim me kusht, në këndvështrim edhe të vendimit unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 2, datë 25.05.2015.

**35.** Lidhur me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë “Për lirimin me kusht” të të dënuarit H.B., magjistrati subjekt i procedimit disiplinor parashtron rrethanat e faktit nga paraqitja e kërkesës së të dënuarit, provat e paraqitura nga vetë i dënuari si dhe provat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, pjesë e të cilit ka qene dhe Raporti i Vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Krujë mbi bazën e të cilit rezultonte se deri më datë 24.01.2019 i dënuari H.B kishte vuajtur 19 (nëntëmbëdhjetë) vite, 6 (gjashtë) muaj e 11 (njëmbëdhjetë) ditë, ndërkohë që periudha e mbetur e dënimit konsistonte në 5 (pesë) vite, 5 (pesë) muaj e 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë. Gjithashtu sipas subjektit nën hetim rezulton se, me Raportin nr. ekstra prot, datë 17.01.2019, I.E.V.P Fushë-Krujë ka raportuar për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë se i dënuari H. B. ka pasur sjellje shumë të mirë,

bazuar kjo në kontaktet dhe dosja personale e të dënuarit, gjithashtu I.E.V.P Fushë-Krujë ka depozituar edhe vlerësim sjellje për disa periudha 6 mujore.

36. Magjistrati parashtron se në zbatim të detyrave të tij funksionale, konkretisht neneve 24 të Kodit të Procedurës Penale, neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 9331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar **ka kryer një verifikim të plotë të dokumentacionit të administruar gjatë gjykimit**, duke kërkuar kohë që të njihet me konkluzionet e avokatit dhe me provat dhe se në seancën gjyqësore të datës 22.02.2019 në konkluzionet e tij ka vënë në dijeni për gjykatën mbi problematikën e vetme që konstatonte, që kishte të bënte me periudhën 5 vite e 5 muaj, e cila duhej mbajtur në konsideratë nga gjykata si periudhë prove, ndërsa në bindjen e tij të brendshme kërkimi i të dënuarit H.B., plotësonte kriteret e parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal, bindje e cila është ndikuar edhe nga koncepti i vetë amnistisë dhe aplikimi i këtij koncepti nga gjykatat shqiptare (neni 71 i Kodit Penal). Në vijim magjistrati ka bërë edhe një përlllogaritje të vetën nga pikëpamja matematikore sipas të cilës: 25 vite burg janë 300 muaj burg, pra në kushte ideale  $\frac{3}{4}$  e dënimit janë 225 muaj, ose 18 vite e 9 muaj, ndërsa  $\frac{1}{4}$  e dënimit janë 75 muaj, ose 6 vite e 3 muaj. Në rastin e dënuarit H.B, rezulton se, atij i kishte mbetur për të vuajtur dhe 6 vite, 6 muaj e 11 ditë, pa përlllogaritur amnistinë e përfituar. Gjithashtu rezulton e provuar se, i dënuari H.B ka përfituar ulje dënimi në masën 90 ditë, ose 3 muaj dhe po të zbritet kjo periudhë nga periudha e mbetur për të vuajtur pa përlllogaritur amnistinë, periudha e mbetur për të vuajtur i dënuari H.B është 6 vite e dy muaj e 16 ditë, çka përbën një periudhë më të vogël se vlera e përcaktuar si  $\frac{1}{4}$  e dënimit prej 25 vitesh.

37. Lidhur me konstatimin e I.L.D-së për mosankimin e vendimit, magjistrati nën hetim disiplinor parashtron se me ndryshimet e reja ligjore, pavarësisht të drejtës së ankimit, vendimi për lirimin me kusht dhe i vënë në provë bëhet i ekzekutueshëm menjëherë bazuar kjo në parashikimet e nenit 59, paragrafi i katërt i Kodit Penal. Magjistrati parashtron se nisur nga bindja e tij edhe sikur i ndjeri H.B., të vuante 25 vite pa asnjë amnisti, apo pa iu zbritur asnjë ditë nga dënimi 25 vjeçar, përsëri ngjarja e e vrasjes së tij do të ndodhte dhe kjo nuk ka të bëjë me veprimet e përfaqësuesit të organit të akuzës apo gjykatës, por me bindjen dhe vullnetin e palës që ka kryer aktin fatal ndaj H.B.

38. Lidhur me argumentimin e I.L.D-së, se magjistrati subjekt i procedimit disiplinor me veprimet e tij ka kryer shkelje të rënda disiplinore, që kanë diskredituar pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, magjistrati Bujar Memia parashtron se praktika gjyqësore shqiptare e ka qartësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente konceptin e cënimit të moralit, ndërgjegjes dhe sigurisë së veprimtarisë së rregullt e të ndershme gjyqësore të funksionarëve të drejtësisë, veçanërisht të gjyqtarëve. Gjykata e Lartë, në qëndrimin e saj koherent dhe të vazhdueshëm për çështje të kësaj natyre, ka konkluduar se: “[...]...Sipas shkronjës "c" të pikës 2 të nenit 32, të ligjit nr. 9877/ 2008, i ndryshuar, "2. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit ndër të tjera kur këto shkelje kanë passjellë, ose mund të sillnin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë [...]”. Në interpretim të kësaj dispozite, në harmoni me dispozitat kushtetuese, nenet 128, 14 dhe 147/6 të Kushtetutës, që të ndodhemi përpara rastit të kryerjes së shkeljeve shumë të rënda dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit duhet domosdoshmërisht të ekzistojnë në mënyrë kumulative këto kushte: (i) shkelja të jetë e pajustificuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale; (ii) shkelja jo vetëm të jetë e pajustificuar dhe e përsëritur, por ajo njëkohësisht të ketë sjellë, ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, apo në dhënien e drejtësisë...[...]. Referuar këtij interpretimi, magjistrati parashtron se mungesa e ekzistencës qoftë edhe vetëm i njërit prej këtyre kushteve bën që të mos ndodhemi përpara



shkeljes shumë të rëndë, në kuptim të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 32 në lidhje me pikën 1 të po kësaj dispozite dhe pikën 2, të nenit 3 të ligjit nr. 9877/ 2008.

## **II. VEPRIMET PROCEDURALE DHE VENDIME TË NDËRMJETME TË MARRA NGA KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË DHE KOMISIONI DISIPLINOR**

39. Nga ana e Komisionit të Disiplinës, në zbatim të parimit të një procesi të rregullt administrativ si dhe parimit të ligjshmërisë përcaktuar nga neni 100 i Ligjit për Statusin ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale, në përputhje të plotë me ligjin dhe rregulloren e “Disiplinës”.
40. Nga ana e Komisionit u verifikua plotësimi i kritereve formale të kërkesës së ILD-së për procedim disiplinor, konform nenit 24, të Rregullores së “Disiplinës”.
41. Menjëherë, me marrjen e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të prokurorit Bujar Memia, me datë 19.01.2021, Komisioni i Disiplinës, është mbledhur dhe ka caktuar me short Relatorin e çështjes, i cili ka filluar menjëherë punën për përgatitjen e çështjes.
42. U verifikua mungesa e kushteve për *“mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore”* sipas parashikimeve të nenit 139, të ligjit “Për Statusin” dhe nenit 25 të Rregullores së “Disiplinës”.
43. Në mbledhjen Plenare më të afërt të Këshillit me datë 27.01.2021, me propozim të Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin Nr.29, datë 27.01.2021, vendosi të caktojë datën 15 Shkurt 2021 për zhvillimin e seancës dëgjimore,
44. Me vendimin nr.42 datë 10.02.2021, Këshilli vendosi shtyrjen e datës së zhvillimit të seancës dëgjimore me 1 muaj, për ti dhënë kohë dy anëtarëve të rinj të Këshillit (njëri prej të cilëve edhe anëtar i Komisionit Disiplinor), të njiheshin me materialet e dosjes hetimore. Kjo seancë u zhvillua me datë 16.03.2021.
45. Seanca Plenare në lidhje me diskutimin dhe vendimmarrjen mbi këtë procedim disiplinor, u zhvillua me datë 31.03.2021, brenda afatit 2 javor nga mbyllja e seancës dëgjimore.
46. Të gjitha vendimet e marra nga Këshilli në kuadër të këtij procedimi, i janë njoftuar palëve konform rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligj.

## **III. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Këshilli, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ILD dhe subjekti i procedimit disiplinor, arsyeton se:

47. Procedimi disiplinor ndaj një prokurori të filluar nga organi kompetent duhet të zhvillohet dhe shqyrtohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Për Statusin”, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, të akuzës, të barazisë para ligjit, të prezumimit të pafajësisë, të proporcionalitetit etj.
48. Në lidhje me vlerësimin dhe mungesën e ligjshmërisë së ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit, pretenduar nga subjekti i procedimit disiplinor si gjatë parashtimeve në fazë hetimore edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, sa i takon mungesës së dispozitave ligjore të “Ligjit për Statusin”, që përcaktojnë shkeljet disiplinore të magjistratit, gjatë dhe jashtë



ushtrimit të detyrës, për shkak të shfuqizimit të tyre me vendimin nr 34/2017, të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli vlerëson se, legjislacioni në fuqi dhe konkretisht neni 124, i Ligjit për Statusin, përcakton se “*Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “c”, “d” dhe “dh”.* Ndërsa neni 120, pika 1, shkronjat d) dhe dh) përcaktojnë se që një ankesë (në rastin konkret verifikimi ka filluar me iniciativë t ILD) të jetë e pranueshme duhet ndër të tjera të ajo (ankesa) duhet të bëhet ndaj sjelljes së magjistratit të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe nga ligji në fuqi në momentin e verifikimit të ankesës.

49. Sipas arsytimit të ILD-së, Bazuar në parimin e hierarkisë së akteve të parashikuar në nenin 116, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë çmohet se ky kriter pranueshmërie duhet të verifikohet në zbatim të drejtpërdrejtë të aktit normativ më të lartë, dhe konkretisht nenit 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon shprehimisht se: “*Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës*”.

50. Ndërsa nga subjekti i procedimit dhe përfaqësuesit e tij, është pretenduar se në rastin në fjalë jemi përpara parimit të specialitetit, sipas të cilit në rast se dy norma rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet ajo normë cili e rregullon këtë marrëdhënie në mënyrë të posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme.

51. Nga ana e Këshillit vlerësohet se parimi i specialitetit do aplikohet nëse do të kishim konflikt ndërmjet një ligji specifik dhe një ligji të përgjithshëm. Në këtë rast nuk mund të kemi konkurrim ndërmjet një norme kushtetuese dhe një norme ligjore. Në rastin konkret jemi përpara një norme kushtetuese që rregullon në mënyrë specifike këtë çështje si dhe vakumit ligjor i cili është shkaktuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr 34/2016. Normalisht dispozita kushtetuese prevalon mbi çdo normë tjetër ligjore, bazuar kjo mbi parimin e hierarkisë së akteve, sanksionuar nga neni 4 pika 2 dhe neni 116, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte kur vetë Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të posaçëm, i ngritur në nivel Kushtetues, i zbatueshëm për rastin në procedim, si dhe bazuar mbi të drejtën e organit procedues për të referuar dhe zbatuar drejtë për drejtë Kushtetutën, vlerësohet se kriteri i përcaktuar në neni 124 në lidhje me nenin 120, pika 1 shkronja d) të Ligjit për Statusin, konsiderohet i përmbushur, duke legjitimuar verifikimin, hetimin dhe në vijim edhe procedimin disiplinor të magjistratit Bujar Memia.

52. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës, nenit 115, të Ligjit për Statusin, me qëllim identifikimin e **elementeve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor**, duhet të analizohen çështjet si: **(i)** nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt i procedimit disiplinor përbën shkelje dhe nëse po, a është shkelje e rëndë profesionale ose etike, apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale; **(ii)** dhe nëse shkelja disiplinore është e tillë që diskrediton pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

53. Kushtetuta si dhe legjislacioni në fuqi nuk përcaktojnë në mënyrë shteruese se cilat janë shkeljet të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit, gjatë ushtrimit të detyrës. Ngelet detyrë e organit procedues (në varësi të fazës në të cilën ndodhet procedura disiplinore) të përcaktojë rast pas rasti **nëse veprimet apo mosveprime analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të**

**funksioneve kushtetuese nga këto subjekte. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëzgjatjen e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur**<sup>2</sup>. Për më tepër mungesa e parashikimeve ligjore të shkeljeve disiplinore, nuk mund të sjellë si pengesë mungesën e ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve nga organi i parashikuar me ligj dhe nga ana tjetër nuk mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmbushur funksionin e tij në mënyrë të rregullt apo për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

54. Në analizë të provave të administruara në kuadër të këtij procedimi disiplinor, me qëllim identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë ekzistencën e shkeljes disiplinore, rezulton se në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili diktonte mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, në mbështetje të parashikimeve të nenit 139, nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç” “d” “dh”, nenit 134, pika 1, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të Ligjit për Statusin.

55. Për sa i përket ekzistencës së një veprimi/mosveprimi të magjistratit që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor referuar nenit 117, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar rezulton se veprimtaria e prokurorit në çështjet gjyqësore përkatësisht: (i) Vendimi nr. 65, datë 06.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (ii) Vendimi nr. 82 akti, datë 14.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (iii) Vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (iv) Vendimi Nr. 26, datë 22.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është kryer, brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe asnjë prej çështjeve të sipërcituara nuk është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi disiplinor, për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar.

56. Nga të dhënat e grumbulluara në kuadër të procedimit disiplinor, rezulton se asnjë prej çështjeve të mësipërme nuk ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, me pasojë mbylljen e procedimit sipas parashikimeve të nenit 139, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në rastin konkret, rezulton e provuar gjithashtu se nga ana e magjistratit subjekt i procedimit disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime gjatë kohës që ka qenë në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nuk i ka mbaruar statusi i magjistratit bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të Ligjit nr. 96/2016, ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji.

57. Në analizë të çështjes se nëse nga ana e magjistratit, subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore, apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale vlen të theksohet se në mbështetje të nenit 101, pika 2, të Ligjit për Statusin, kur përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia

<sup>2</sup> Shih vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese

e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë. Duhet të theksohet, se ndonëse pika 2 e nenit 101 të Ligjit për Statusin është ndryshuar me ligjin nr.48/2019 dhe nuk ka qenë në fuqi në kohën kur kanë ndodhur faktet objekt procedimi disiplinor, ato do të merren në analizë, me qëllim që subjekti i procedimit disiplinor, prokurori Bujar Memia, të mos gjendet në një pozitë më pak të favorshme se çdo prokuror tjetër, veprimet/mosveprimet e të cilit, mund të jenë kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.48/2019, për t'u vlerësuar nëse përbënin shkelje disiplinore, përveç parashikimeve Kushtetuese do të merreshin në konsideratë edhe faktorët e sipërcituar<sup>3</sup>.

**58.** Nga ana tjetër, në analizë të çështjes lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, vlen të theksohet se në Ligjin nr. 96/2016 „Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejt se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Neni 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës parashikon konceptin e shkeljeve shumë të rënda për shkarkimin e prokurorit nga detyra. Në këto kushte për të arritur në një përfundim të qartë në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.

**59.** Në nenin 115, pika 1, të Ligjit për Statusin parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

**60.** Në analizë të kriterit “lloji dhe rrethanat e shkeljes” në raport me faktet e provuara gjatë procedimit disiplinor rezulton se pas një vlerësimi të hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, konstatohet se në rastin konkret, nga ana e magjistratit subjekt i procedimit disiplinor Bujar Memia, janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjnë me:

<sup>3</sup> Duhet sqaruar, se çdo referencë në dispozitat e ligjit për statusin, të cilat janë ndryshuar me ligjin nr.48/2019 pra që nuk kanë qenë në fuqi në momentin e kryerjes së veprimeve apo mosveprimeve objekt procedimi disiplinor, behet vetëm për efekt të faktit që magjistrati subjekt i procedimit disiplinor, të mos ketë një pozitë më pak të favorshme se çdo prokuror tjetër, veprimet apo mosveprimet e të cilit kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.48/2019, ku për të vlerësuar: (i) nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale; (ii) kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore; (iii) llojin e masës së disiplinore, do t'i referoheshim Ligjit për Statusin, pas ndryshimeve. Ky interpretim bëhet edhe në referim të nenit 120 pika 1, germa “dh” të ligjit për statusin.

a) Mospërbushjen e pajustificuar e funksioneve gjatë dhe pas gjykimit, të çështjes me nr. vendimi 65 akti, datë 06.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.<sup>4</sup>

b) Mospërbushjen e pajustificuar të funksioneve gjatë gjykimit dhe mosveprime e sjellje të magjistratit që ka sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin, në çështjet me nr. vendimi 82 akti, datë 14.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nr. vendimi 463 akti, datë 21.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.<sup>5</sup>

c) Mospërbushjen e pajustificuar të funksioneve gjatë gjykimit, mosveprime e sjellje të magjistratit që ka sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin si dhe mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, në çështjen me nr. vendimi 26 akti, datë 22.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

## **A. MOSPËRMBUSHJA E PAJUSTIFIKUAR E FUNKSIONEVE GJATË DHE PAS GJYKIMIT, TË ÇËSHTJES ME NR. VENDIMI 65 AKTI, DATË 06.11.2017, TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KRUJË.**

61. Nga analiza ligjore e fakteve të pranuar, bazuar në provat e marra gjatë procedimit, rezulton se magjistrati subjekt i procedimit disiplinor gjatë dhe pas shqyrtimit të çështjes nr.65 akti, datë 06.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ka kryer veprime apo mosveprime në zbatim të gabuar të ligjit, duke mos përmbushur detyrat e tij funksionale.

62. Nga aktet e administruara gjatë procedimit disiplinor ka rezultuar se i dënuari I.P ka paraqitur fillimisht më datë 07.10.2016 kërkesën penale me objekt “Lirim për shkak sëmundje” parashikuar nga neni 478 të K.Pr.Penale, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtarës tjetër E.T.. Gjyqtarja ka marrë vendim për caktimin e një grupi ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit. Në vijim të gjykimit është paraqitur kërkesë e të dënuarit për përjashtim të gjyqtarës nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin e datës 23.01.2017. Në vijim i dënuari ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, mbi bazën e të cilës gjyqtarja E.T, ka pushuar çështjen me vendimin nr. 8/54 akti, datë 08.02.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Prokuror në këtë çështje rezulton të ketë qenë një prokurori tjetër .S.T.

<sup>4</sup> Në mbështetje të nenit 101, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, magjistrati kryen shkelje disiplinore me dashje ose pakujdesi të rëndë, kur kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mos përmbushje të detyrës, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Në të njëjtën kohë, në nenin 102, pika 1 shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: ...[...].ç) mos përmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit”.

<sup>5</sup> Në mbështetje të nenit 101, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, magjistrati kryen shkelje disiplinore me dashje ose pakujdesi të rëndë, kur kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mos përmbushje të detyrës, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Në të njëjtën kohë, në nenin 102, pika 1, shkronja “dh”, të Ligjit për Statusin parashikohet shprehimisht se: “Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:...[...].dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin”.



63. Ndërkohë ka rezultuar se i dënuari I.P ka paraqitur më datë 17.07.2017 kërkesën penale me objekt "Aplikim dënimi alternativ, qëndrim në shtëpi" regjistruar me nr. 63 akti, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtares E.T. Në këtë çështje nuk është paraqitur përfaqësues nga organi i akuzës.

64. Më datë 25.07.2017 i dënuari \_\_\_\_\_ tashmë me emrin \_\_\_\_\_ ka paraqitur kërkesën penale me nr. 65 akti me objekt: "Qëndrim në shtëpi", e cila pas shortit elektronik (emri i kërkuesit është pasqyruar i ndryshëm), i ka kaluar për shqyrtim magjistrates E.H. Pra i dënuari de facto, ka pasur dy gjykime me të njëjtin objekt tek dy gjyqtare të ndryshme, ndërsa prokurori Bujar Memia rezulton të ketë qënë vetëm në çështjen me nr. 65 akti.

65. Në gjykimin e regjistruar më parë pranë gjyqtares tjetër E.T., i dënuari nuk është paraqitur dhe gjyqtarja ka vendosur mospranim kërkesë, ndërsa i dënuari ka vijuar shqyrtimin e kërkesës tjetër me të njëjtin objekt pranë gjyqtares E.H.. Gjatë gjykimit gjyqtarja nuk ka kryer asnjë verifikim apo veprim procedural mbi identitetin e kërkuesit në raport me aktet e dosjes si dhe personin fizik të shoqëruar në gjykim, ndërsa vendimi gjyqësor pasqyron si kërkues shtetasin me gjeneralitetet e sakta Ilir Paja. Megjithëse nuk provohet se prokurori Bujar Memia ka pasur dijeni për 2 proceset gjyqësore të cilat kanë qënë në gjykim pranë gjyqtares tjetër E.T., mosparaqitja e kërkesave nga prokurori mbi verifikimin e identitetit të kërkuesit, dhe mosverifikimi kryesisht as nga ana e gjykatës, ka sjellë mundësinë e të dënuarit të përzgjedhë gjyqtarin për gjykimin e çështjes, për më tepër që gjyqtarja tjetër për çështje të ngjashme kishte vendosur kryerjen e ekspertimit mjeko - ligjor të tij.

66. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje me vendimin nr. akti 65, datë 06.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është aplikuar dënimi alternativ "Qëndrim në shtëpi", parashikuar nga neni 59/a i K.Penal, duke u vendosur: "*Pranimi i kërkesës. Aplikimin e dënimit alternativ "Qëndrim në shtëpi" për kërkuesin I.P, për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 vit 8 muaj dhe 9 ditë burgim duke e vënë në provë për një periudhë kohore prej 1 vit dhe 8 muaj. Të lejohet kërkuesi I.P që të largohet nga banesa e tij për plotësimin e nevojave të domosdoshme e konkretisht të trajtimeve dhe shërbimeve shëndetësore kjo referuar dhe raportit të vlerësimit datë 12.10.2017 të Shërbimit të Provës. Urdhërohet i dënuari I.P që gjatë kohës së qëndrimit në shtëpi t' i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit I.P nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi...[...]."*

67. Nga të dhënat e administruara është konstatuar se gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar me pjesëmarrje të prokurorëve B.Ç (në seancat e datës 08.09.2017, 20.09.2017<sup>6</sup>), F.B (në seancat e datës 12.10.2017, 16.10.2017<sup>7</sup>) dhe në fund të prokurorit Bujar Memia (në seancat e datës 03.11.2017 dhe 06.11.2017), deri në dhënien e vendimit nr. 65 akti, datë 06.11.2017. Gjatë pranisë së dy prokurorëve të tjerë janë paraqitur aktet nga ana e kërkuesit, është caktuar detyra shërbimit të provës për hartimin e raportit të vlerësimit si dhe është vendosur pyetja e përgjegjësit të shërbimit shëndetësor në I.E.V.P.

68. Prokurori Bujar Memia është paraqitur në seancën e datës 03.11.2017, në të cilën është pyetur përgjegjësi i shërbimit shëndetësor në I.E.V.P lidhur me gjendjen shëndetësore të kërkuesit si dhe janë administruar raporti i shërbimit të provës dhe i provave të tjera shkresore. Nga përmbajtja e procesverbalit gjyqësor konstatohet se nga ana e prokurorit Bujar Memia në seancën e datës 03.11.2017 janë parashtruar dy pyetje shefit të shërbimit shëndetësor në I.E.V.P.: (i) **pse nuk janë**

<sup>6</sup> Në seancën e datës 04.10.2017 nuk ka pasur përfaqësues prokurorie, pasi B.Ç është komanduar në një prokurori tjetër.

<sup>7</sup> Në seancën e datës 25.10.2017 nuk ka pasur përfaqësues prokurorie, pasi prokurori F.B nuk është paraqitur.



**kryer në burg këto intervenime**, në përgjigje të cilës mjeku ka deklaruar se: *“Spitali i burgut nuk i ofron të gjitha shërbimet, ne e dërgojnë në spital të burgut dhe spitali pastaj....[...].: (ii) nisur nga larmia e sëmundjeve, a janë të tilla që kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme shërbim shëndetësor, në përgjigje të të cilës mjeku ka deklaruar “Problematikat e tij të shumta, ai duhet herë pas herë të bëjë kontrolle, ekzaminime, vizita”.*

69. Në të njëjtën seancë avokati i kërkuesit ka paraqitur si provë të re dinamikën e vuajtjes së dënimit dhe megjithëse kishte kaluar faza procedurale e parashikuar nga neni 356 i K.Pr.Penale, prokurori ka qenë dakord me administrimin e saj. Në të kundërt të këtij qëndrimi të tij në seancë, prokurori në parashtrimet e veta të paraqitura në I.L.D, ka theksuar se në momentin që është paraqitur ai si përfaqësues i organit të akuzës në këtë çështje, kishte kaluar faza procedurale e kërkesave të palëve për marrje provash të parashikuara nga neni 356 i K.Pr.Penale. Ndërkohë rezultoi gjithashtu se në kohën e pjesëmarrjes së prokurorit Bujar Memia në seancë, nuk ishte kaluar në fazë diskutimi referuar nenit 378 të K.Pr.Penale, pra shqyrtimi gjyqësor ka qenë ende në fazën e marrjes së provave dhe nuk rezultoi të jetë kërkuar nga ana e magjistratit që një provë e tillë të merrej kryesisht nga ana e gjykatës në zbatim në nenit 366 të K.Pr.Penale.

70. Referuar nenit 366 të K.Pr.Penale, prokurori si palë në gjykim që përfaqëson interesin publik në çështje ka pasur të gjitha mundësitë të parashtronte kërkesë për caktim ekspertit kryesisht nga ana e gjykatës, sipas parashikimeve të nenit 178 të K.Pr.Penale mbi raste kur lejohet ekspertim. Dispozita është e aplikueshme në arsyet ligjore të kërkesave të palëve kur kërkohet kjo provë, ashtu edhe kur organi procedues vendos pranimin e kërkesës për marrje të kësaj prove.

71. Fakti i pretenduar se kishte kaluar faza procedurale e parashikuar nga neni 356 i K.Pr.Penale për paraqitjen e kërkesave për marrje prove nga palët në proces, nuk e ndalon prokurorin të paraqesë kërkesa të tjera në zbatim të nenit 366 të K.Pr.Penale. Prokurori nuk mund dhe nuk duhet të paragjykojë vendimmarrjen e gjykatës dhe të mos ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar marrje prove, me argumentin se gjithsesi kërkesa nuk do të pranohej nga ana e gjykatës. Në këtë linjë, nëse prokurori, nuk do të kishte qenë dakord me këtë vendimmarrje të gjykatës pa u marrë prova me ekspert, që sipas logjikës së parashtrimeve të tij ai nuk mund të paraqiste kërkesë për marrjen e kësaj prove pasi kishte kaluar faza procedurale e përcaktuar në ligj, do të kishte ushtuar detyrimisht ankimin ndaj vendimit nr. akti 65, datë 06.11.2017 duke investuar një gjykatë më të lartë, gjë e cila në fakt nuk ka ndodhur.

72. Kjo provon se magjistrati Bujar Memia, jo vetëm që nuk ka paraqitur vetë kërkesë për marrjen e kësaj prove, por ka qenë dakord edhe me dhënien e vendimit pa u marrë një provë e tillë edhe kryesisht nga ana e gjykatës. Për rrjedhojë pretendimet e magjistratit në parashtrimet e veta nuk qëndrojnë. Jo vetëm mungesa e kërkimit nga ana e prokurorit, por edhe mos ngritja e kësaj problematike në konkluzionet përfundimtare të dhëna nga ana e prokurorit, për sa kohë që aktet e administruara nuk ishin në nivelin e provës, përbejnë mos përmbushje të funksionit nga ana e magjistratit.

73. Prokurori Bujar Memia nëpërmjet mos kërkimit të administrimit të provës me ekspert kryesisht nga ana e gjykatës, mos ngritjen e kësaj problematike në konkluzionet përfundimtare dhe për pasojë mos ushtrimin të ankimit ndaj vendimit të gjykatës me nr. akti 65, datë 06.11.2017, me

pasojë marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor për aplikimin e alternativës së dënimit me burgim “Qëndrimin në shtëpi” parashikuar nga neni 59/a, paragrafi 1 shkronja “c” e Kodit Penal, në favor të të dënuarit I.P, pa u krijuar mundësia e kontrollit gjyqësor të kësaj vendimmarrje lidhur me provueshmërinë e kushteve të parashikuara në këtë dispozitë, **nuk ka përmbushur në mënyrë të pajustificuar funksionet e tij gjatë gjykimit sikundërse është mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit penal dhe përfaqësimi i interesit publik në këto çështje.**

74. Nga vlerësimi i provave të administruara, rezulton e provuar se, në shqyrtimin e kësaj çështje përveç dosjes së I.E.V.P bashkëlidhur kartela klinike në të cilën ndodhen edhe ekzaminimet e kryera nga i dënuari në një spital privat në muajin prill të vitit 2017 dhe administrimit të raportit të Zyrës së Shërbimit të Provës, gjykata në seancën e datës 03.11.2017 ka thirrur në cilësinë e dëshmitarit përgjegjës in e shërbimit shëndetësor të I.E.V.P-së, i cili u është përgjigjur pyetjeve të prokurorit dhe të gjykatës. **Ndërkohë në dosjen gjyqësore është administruar edhe shkresa “Informacion shëndetësor për të dënuarin I.P” e hartuar dhe ë nënshkruar po nga përgjegjësi i shërbimit shëndetësor në datë 02.11.2017 (një ditë më parë), e cila përshkruan gjendjen shëndetësore të të dënuarit, si dhe garantohet përkujdesje maksimale mjekësore ndaj tij.** Të dhënat mjekësore të cilat ka administruar gjykata kanë qenë të një periudhë të mëparshme, rreth 7 muaj më herët nga dhënia e vendimit.

75. Në vijim prokurori Bujar Memia nuk ka parashtruar kërkesa të tjera procedurale në gjykim në funksion të provueshmërisë së kriterëve të parashikuara nga neni 59/a, shkronja “c” e Kodit Penal. Mosparaqitja e një kërkesë të tillë nuk ka ardhur për shkaqe procedurale pavarësisht se nga magjistrati pretendohet edhe ky shkak, por për shkak të bindjes së magjistratit se kriteret e kësaj dispozite ishin plotësuar me provat e marra në gjykim. **Rezulton se prokurori i çështjes Bujar Memia në përfundim të gjykimit është shprehur se: “Ka përputhje me dispozitat e nenit 59/a të K.Penal lidhur me rrethanat e rënda shëndetësore, po kështu dhe nga pyetja që ju bë, që ishte mjeku. Me ndryshimet e legjislacionit në procedurë penale, e lë në çmim të gjykatës.”**

76. Ky qëndrim i magjistratit në seancë është përforcuar edhe pas dhënies së vendimit nr. 65 akti, datë 06.11.2017 me mos-ushttrimin e ankimit ndaj vendimit.

77. Dënimi alternativ “Qëndrimi në shtëpi” është një formë e re e vuajtjes së dënimit me burgim, e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, shtuar me nenin 2, të Ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

**Së pari:** Kur të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur jo më shumë se dy vjet burgim<sup>8</sup>, sipas një vendimi të dhënë më parë për një periudhë më të gjatë se dy vjet burgimi;

**Së dyti:** Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme: ..[...]...c) “Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut”. Gjykata ka detyrimin ligjor të shqyrtojë gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit për të vendosur më pas sipas rregullave të parashikuara në ligj. Në gjykimin

<sup>8</sup> Ky kusht rezulton të jetë analizuar nga gjykata si i plotësuar

e kësaj çështje gjykata duhej të ezauronte nga pikëpamja e provueshmërisë, plotësimin e njëkohshëm të parashikimeve të kësaj dispozite:

- kushtet e rënda shëndetësore të të dënuarit;
- kushtet shëndetësore të jenë të natyrës që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor;
- ky kujdes i vazhdueshëm shëndetësor kërkohet jashtë burgut, pra që nuk mund të ofrohet brenda spitalit të burgut.

78. Natyra e veprimeve procedurale të kryera nga gjykata gjatë këtij procesi gjyqësor, në zbatim të funksioneve të veta nuk ka qenë ezauruese në drejtim të hetimit gjyqësor mbi plotësimin e kushteve të kërkuara nga neni 59/a, pika 1, shkronja “c” e Kodit Penal, për të disponuar në mënyrë të paanshme ndaj kërkesës të të dënuarit I.P. Ato shërbejnë si indicje për marrjen e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme shkencore nga ekspertë të fushës sikundërse janë mjekët ligjorë pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.

79. Të dhënat e administruara vërtetojnë problemet shëndetësore të të dënuarit, por jo impaktin që ato kanë në jetën dhe shëndetin e tij. Këto të dhëna nuk provojnë pamundësinë e dhënies së kujdesit të vazhdueshëm ndaj tij brenda spitalit të burgut. **Të gjitha këto dokumente të cilat janë marrë në shqyrtim dhe vlerësuar nga gjykata, janë indicje dhe nuk përbëjnë provë në kuptimin që i jep ligjvënësi në dispozitën e nenit 149 të K.Pr.Penale**, i cili parashikon: “*Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij*”, ndërsa ekspertimi është parashikuar në nenin 178 të K.Pr.Penale si një nga llojet e provave i cili merret kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore. Marrja e këtij vlerësimi për efekt provueshmërie referuar nenit 178 të K.Pr.Penale, kryhet vetëm me anë të aktit të ekspertimit mjeko - ligjor, nga organi procedues që është gjykata, e cila ka në shqyrtim çështjen sipas parashikimeve të nenit 182 të K.Pr.Penale, ndërsa prokurori si palë në gjykim ka pasur detyrimin të kërkojë marrjen e kësaj prove pranë organit procedues dhe të mos mjaftohet me indicjet e marra në gjykim.

80. Raporti i Shërbimit të Provës është provë e cila sigurisht që ka vlerën e vet në kuadër të të gjitha provave të marra në gjykime të këtij lloji, referuar nenit 59/a të Kodit Penal dhe dispozitave të posaçme të Ligjit nr. 1024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, por në asnjë rast ai nuk zëvendëson mendimin e specializuar të ekspertëve të fushës për gjendjen shëndetësore të të dënuarit dhe për të vlerësuar nëse kujdesi i vazhdueshëm shëndetësor ndaj të dënuarit mund të jepet në kushtet e burgut apo vetëm jashtë saj. Për rrjedhojë argumentet e magjistratit të paraqitura në parashtrimet e veta gjatë hetimit disiplinor nuk qëndrojnë.

81. Në funksion të shkeljes disiplinore, konstatohet se megjithëse nga gjykata nuk janë zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, lidhur me parashikimet e nenit 152 dhe 380 të këtij Kodi. Neni 152 “Çmuarja e provave” parashikon shprehimisht se: “1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj. 2.

*Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Neni 380 “Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin” parashikon se: “1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor”, magjistrati nën hetim disiplinor nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës me nr. akti 65, datë 06.11.2017 me pasojë marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor për aplikimin e alternativës së dënimit me burgim “Qëndrimin në shtëpi” parashikuar nga neni 59/a, paragrafi 1, shkronja “c” e Kodit Penal, në favor të të dënuarit I.P, pa u krijuar mundësia e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, të kësaj vendimmarrje lidhur me provueshmërinë e kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.*

**82.** Në funksion të pretendimit të tij për moskryerjen domosdoshmërisht të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor në çështje të kësaj natyre, magjistrati referon në vendimin nr. 140 akti, datë 20.10.2014 me kërkues B.S me objekt: “*Aplikim dënimi alternativ, qëndrim në shtëpi*” parashikuar nga neni 59/a, pika 1, shkronja “c”, të Kodit Penal, në të cilën një provë e tillë nuk është marrë gjatë gjykimit, vendim që sipas magjistratit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 972, datë 13.05.2015 dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. 2420, datë 17.09.2015 ka vendosur “*Mospranim rekursi*”, si dhe vendimi nr. 16/185 akti, datë 16.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

**83.** Nga përmbajtja e tyre rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 972, datë 13.05.2015 vërtet ka lënë në fuqi vendimin nr. 140/2014 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, por për shkaqe të tjera. Në pjesën arsyetuese Gjykata e Apelit Tiranë arsyeton se megjithëse ka gjetur të bazuara mjaft nga problemet që prokuroria ngre në ankim (*një nga të cilat është mungesa e aktit të ekspertimit mjeko ligjor nga I.M.L*), pas riçeljes dhe shqyrtimit gjyqësor nga vetë gjykata e apelit, ka lënë në fuqi vendimin me disa plotësime. Në pjesën arsyetuese gjykata ka theksuar mangësitë në arsyetimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke u shprehur se, gjykata nuk analizon gjendjen shëndetësore të kërkuesit ndërsa vlerëson rrethana të tjera të cilat nuk ndikojnë në zgjidhjen e çështjes. Gjykata e Apelit pas provave të administruara edhe nga ana e saj, ka vlerësuar se i dënuari kishte një gjendje shëndetësore problematike në periudhë kohore të zgjatur e që ka marrë mjekim, ndërsa ka vlerësuar se mbas 19 vite burgim dhe në kohën e shqyrtimit të çështjes prej saj i dënuari kishte 7 muaj në banesë ku ka vazhduar marrjen e mjekimit dhe një rikthim i tij për të vuajtur edhe pjesën e mbetur të dënimit prej rreth 1 vit, është vlerësuar se do të ndërpriste kujdesin shëndetësor të nisur tashmë jashtë burgimit dhe pavarësisht mjekimeve në ambientin e burgut, do të ndikonte negativisht në gjendjen e tij shëndetësore.

**84.** Fakti që Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 2420, datë 17.09.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit nuk ka të bëjë me mënyrën dhe faktin se gjykata e ka zgjidhur drejt çështjen e kërkuesit B.S, por provon se rekursi nuk përmbush kriteret e nenit 433, të Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë pretendimet e magjistratit gjenden të pabazuara. Ndërsa vendimi tjetër i paraqitur si provë nga magjistrati nr. 16/185, datë 16.02.2015, i paankimuar nuk shërben si shkak për të provuar mungesën e shkeljes disiplinore.

**85.** Sa i takon çështjes procedurale mbi administrimin e akteve të ekspertimit në çështje të kësaj natyre, në të kundërt të pretendimeve të magjistratit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka jurisprudencë të konsoliduar mbi llojin e provës që duhet marrë në drejtim të konstatimit të faktit

të papajftueshmërisë së qëndrimit të mëtejshëm në institucione të paraburgimit/ burgimit, gjendja shëndetësore apo sociale e personit që mbahet në burg, duke u provuar nëpërmjet një akt ekspertimi të caktuar sipas rregullave të përgjithshme të procedurës penale<sup>9</sup>.

**86.** Kështu në vendimmarrjet e veta Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se, nëpërmjet mjetit procedural të ekspertimit gjykata synon vërtetimin dhe sqarimin e të dhënave provuese duke i mundësuar asaj dhënien e elementeve të nevojshme për përcaktimin e ngjarjeve dhe vërtetimin e fakteve. Vetëm pasi të jetë vërtetuar rëndësia për lejimin e ekspertimit të vendosur kryesisht apo të kërkuar nga palët, gjykata ka detyrimin për të proceduar me pranimin e ekspertimit të nevojshëm për zhvillimin e hetimit gjyqësor, vërtetimin e ngjarjeve, kërkimeve ose marrjes së të dhënave ose të vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore të nevojshme për arritjen e vendimit nga ana e gjykatës. Prandaj gjykata edhe kryesisht, kur e çmon të nevojshme duhet të lejojë marrjen e provës me ekspertë të fushës në rastet e gjykimit të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve, sipas Kreut II të Titullit të IX të Kodit të Procedurës Penale. Kjo në bazë të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penale, ku gjykata procedon në cilësinë e gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve<sup>10</sup>.

**87.** Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në gjykimin e çështjeve me objekt: “Aplikim dënimi alternativ “Qëndrim në shtëpi” është theksuar se: “Në lidhje me kushtin e veçantë, të parashikuar nga 59/a, vërtetimi i faktit nëse i dënuari e plotëson apo jo këtë kusht, domosdoshmërisht nënkupton marrjen e provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore duke kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm”. Kolegji Penal thekson se hetimi i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes, në përputhje me ligjin, është parim themelor i gjykimit penal dhe përbën një detyrim për gjykatat në të gjitha shkallët e gjykimit. Në këtë kuptim në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes është e nevojshme kryerja e hetimit të plotë qoftë duke përsëritur hetimin gjyqësor dhe në përputhjen me nenin 154 të K.Pr.Penale, gjykata duhet të bëjë një analizë tërësore dhe objektive të provave. Ajo duhet të çmojë provat e marra në shqyrtim, sipas bindjes së brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Hetimi gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm, për të provuar parashtrimet apo prapësimet e palëve, me mjetet provuese të lejueshme që Kodi i Procedurës Penale parashikon, është detyrë e gjykatës së faktit. Kolegji ka cenuar vendimin duke lënë detyrë gjykatës të caktojë ekspertë apo grup ekspertësh për të bërë akt ekspertimin i cili është i domosdoshëm në këtë rast për të përcaktuar se cila është gjendja shëndetësore, natyra e sëmundjes... etj<sup>11</sup>.

**88.** Konsistent ka qenë qëndrimi i Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, edhe në vendimin 31/ 2016 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë: “...[...]...Çmon të theksojë se gjykatat e themelit kur gjykojnë kërkesa që kanë të bëjnë me mbrojtjen e së drejtës themelore të jetës, nuk mund të përdorin

<sup>9</sup> Shiko vendimin nr. 161, datë 02.07.2014 të Kolegjit Penal me kërkues E.T me objekt “Zëvendësim mase për shkaqe shëndetësore” ku parashikohet shprehimisht se: “...[...]...Vetëm në ato raste kur nga ana e autoritetit shtetëror mbikëqyrës të paraburgimit nuk mund të sigurohet një trajtim i kualifikuar mjekësor i sëmundjes dhe mungesa e tij vë në rrezik jetën apo shëndetin; gjendja shëndetësore e personit mund të shërbejë si shkak për ndryshimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, nëse ekzistojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme dhe kur ky shkak arsyetohet pas kryerjes së hetimit dhe vlerësimit në bazë të provave përkatëse të administruara në seancë në përputhje me parimin e kontradiktoritetit...[...].”

<sup>10</sup> Shiko vendimin nr. 31, datë 02.03.2016 të Kolegjit Penal me kërkues A.A, me objekt: “Lirim i të burgosurit në bazë të nenit 478 të K.Pr.Penale”.

<sup>11</sup> Shiko vendimin nr. 176, datë 16.07.2014 me kërkues A.A me objekt: “Aplikim dënimi alternativ “Qëndrim në shtëpi”.



arsyetimin e rasteve analoge për të vendosur rrezimin e kërkesës, pasi çdo rast është i lidhur me kushtet shëndetësore, gjendjen e të sëmurit, dhe rrethanat e tjera personale dhe të veçanta që ndryshojnë rast pas rasti. Kolegji vlerëson se në kushtet kur prova shkencore arrin në përfundimin kategorik se personit të dënuar i rrezikohet jeta, vlerësimi i realitetit të rrezikut, i gravitetit të gjendjes, dhe mos reagimi i personit ndaj trajtimit mjekësor janë të gjitha elementë që duhet të përcaktohet nëpërmjet provës shkencore....[...].”

89. Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, provohet se magjistrati Bujar Memia në ushtrimin e funksionit të prokurorit në gjykimin e kësaj kërkesë penale të të dënuarit I.P. me nr. akti 65 dhe pas dhënies së vendimit përfundimtar për këtë çështje në datë 06.11.2017, **ka kryer shkelje profesionale**, që konsistojnë në qëndrimin e mbajtur nga ana e prokurorit në seancë, mosparaqitjes së kërkesave procedurale për marrjen e një prove vendimtare për zgjidhjen e çështjes të parashtruar për shqyrtim, sipas parashikimeve të neneve 178 dhe 366 të K.Pr.Penale, konkretisht akti i ekspertimit mjeko - ligjor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit, për të vlerësuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 59/a paragrafi 1, shkronja “c” e Kodit Penal.

90. Qëndrimi i prokurorit Bujar Memia në seancë në ushtrim të funksioneve të veta, roli i tij apo pyetjet e shtrua mjekut, nuk kanë qenë ezauruese në drejtim të hetimit gjyqësor mbi plotësimin e kushteve të kërkuara nga neni 59/a, pika 1, shkronja “c” e Kodit Penal, për të disponuar gjykata ndaj kërkesës të të dënuarit I.P.

91. Nga përmbajtja e dosjes penale të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, rezulton se më datë 17.11.2017, drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë aktin “Udhëzim” lidhur me vendimin gjyqësor nr. 65 akti, datë 06.11.2017 për të dënuarin I.P.”, në të cilin ka vlerësuar se në çështjen konkrete vendimi i gjykatës nuk është marrë në analizë të të gjitha provave që duhej të administroheshin gjatë gjykimit dhe si i tillë nuk është i drejtë dhe i bazuar në prova duke arsyetuar se: “*...[...]. Në gjykimin tim kjo ka qenë e pamjaftueshme dhe do të duhet që Gjykata të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor për të dënuarin, konkluzionet e të cilit do të shërbenin për të marrë një vendim të drejtë. Në këtë kuadër gjykoj se është e nevojshme që ndaj këtij vendimi të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë...[...]*”. Në përfundim të këtij akti drejtuesi i prokurorisë, në zbatim të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit Nr. 02, datë 29.12.2016, Kreu II, pikat 2 dhe 3 të Prokurorit të Përgjithshëm ka udhëzuar: “Ankimin e vendimit nr. 65 akti, datë 06.11.2017 brenda afatit ligjor datë 21.11.2017. Të njohë me këtë udhëzim prokurorin Bujar Memia. Në rast se prokurori i çështjes nuk është dakord me këtë udhëzim të paraqesë arsyet me shkrim. Udhëzimi bëhet pjesë e fashikullit dhe është urdhëruar sekretaria të bëjë njoftimet përkatëse”.

92. Në kushtet e mungesës së ankimit, në vijim më datë 21.11.2017 prokurori i ekzekutimeve ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimin penal nr. 65 akti, datë 06.11.2017 për zbatimin e ekzekutimit të tij.

93. E gjithë kjo sjellje e magjistratit Bujar Memia në çështjen e të dënuarit I.P. provon se dukshëm veprimtaria e tij nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 24, 25/2 të K.Pr.Penale si dhe



pikat 3 dhe 4, të nenit 53 të Ligjit nr. 9331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar, pasi nuk rezulton të jetë udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë dhe i paanshmërisë.

94. Referuar nenit 24 të K.Pr.Penale prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre. Ndërsa në nenin 25/2 të K.Pr.Penale parashikohet se: *“Në ushtrimin e funksioneve të tij, prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj”*.

95. Në nenin 4, të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, është sanksionuar detyrimi i ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë. Prokurorët më ushtrimin e detyrës, u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve të tjera në fuqi. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

96. Ndërsa në nenin 6 është parashikuar pavarësia e prokurorëve. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashtrajnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë. Prokurori ka autonomi në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore për kryetjen e veprimeve procedurale, parashtrimin e kërkesave dhe marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm gjatë përfaqësimit të çështjes në gjykatë dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale apo mbikëqyrjes së zbatimit të tyre.

97. Neni 53 i Ligjit nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, parashikon mënyrën dhe veprimet e prokurorit në realizimin e kontrollit të ekzekutimeve të vendimeve penale nëpërmjet: *“1. Marrjes së njoftimit për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit nga organi përkatës; 2. shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të të dënuarve dhe mbrojtësit të tij; 3. kërkit të informacioneve dhe verifikimeve të drejtpërdrejta mbi dokumente ose në vendin e vuajtjes së dënimit në prani të personit zyrtar përkatës; 4. marrjes dhe verifikimit të njoftimeve për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve; 5. marrjes së mendimit të specialistëve të fushave të ndryshme; 6. bashkëpunimit me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi ose të institucioneve shtetërore të kontrollit administrativ”*.

98. Pavarësia e prokurorit nuk është dhe nuk duhet të shihet e shkëputur nga ushtrimi i funksioneve në bazë të Kushtetutës, marrëveshjeve dhe ligjeve materiale apo procedurale në fuqi, bazuar në parimin e ligjshmërisë dhe të paanshmërisë. E kundërta përbën shkak për abuzim. Në çështjen gjyqësore për të cilën është dhënë vendimi nr. 65 akti, datë 06.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për aplikimin e dënimit alternativ parashikuar nga neni 59/a shkronja “c”, e Kodit Penal, nuk është paraqitur kërkesë për prova nga prokurori dhe as është administruar një provë vendimtare për zgjidhjen e çështjes, e cila për nga natyra e saj kërkon vlerësim të posaçme nga ekspertë të fushës, ndërsa mos ushtrimi edhe i ankimit nga ana e prokurorit ka sjellë që zgjidhja e çështjes nga pikëpamja e provueshmërisë të mos i nënshtrohet kontrollit gjyqësor nga një gjykatë

më e lartë, sjellje e cila tregon se prokurori nuk ka përmbushur në mënyrë të pajustificuar funksionin e vet atë të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale. Me anë të sjelljes dhe qëndrimit të vet, prokurori nuk ka mbikëqyrur nëse aplikimi i këtij dënimi alternativ gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal të caktuar për të dënuarin I.P., ka qenë nga pikëpamja e provueshmërisë në përputhje me parashikimet e ligjit material nenit 59/a shkronja “c”, e Kodit Penal. Përkundrazi me sjelljen dhe qëndrimin e vet prokurori ka siguruar pritshmërinë e të dënuarit për të mos iu nënshtruar vlerësimit të gjendjes së tij shëndetësore nga ekspertë mjeko-ligjore, në një kohë që për të shmangur këtë provë ai kishte hequr dorë më parë nga gjykimi i çështjes pranë një gjykate tjetër në momentin që gjykata vendosi të marrë provë me ekspert për të zgjidhur të njëjtin objekt kërkimi të të dënuarit I.P. (*Shih vendimin nr. 8/54 datë 08.02.2017*).

**99.** Magjistrati në parashtrimet e veta ka pretenduar se ankimi është e drejtë dhe jo detyrim i prokurorit, se është në diskrecion të tij nëse do e ushtrojë këtë të drejtë apo jo. Ky pretendim i magjistratit është i pabazuar, referuar Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”. Sipas këtij ligji pavarësia e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të veta, të garantuar në nenin 6 të Ligjit nr. 97/2016, nuk duhet të jetë abuzive dhe arbitrare, por duhet të bazohet në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë. Në rastin konkret nuk rezulton që prokurori Bujar Memia të ketë ushtruar funksionet e veta në bazë të paanshmërisë, por përkundrazi me anë të qëndrimit të tij në seancë dhe mos-ushtrimin të ankimit, është sjellë me njëanshmëri si përfaqësues i interesit publik me atë individual të të dënuarit. Pikërisht nisur nga argumenti i përdorur nga magjistrati se edhe nëse nga ana e tij do ishte kërkuar administrimi i provës me ekspertë, kjo kërkesë nuk do të ishte pranuar nga ana e gjykatës, themi se prokurori nuk ka përmbushur funksionet e tij, pasi duke kërkuar administrimin e kësaj prove dhe nëse kërkesa nuk do të ishte pranuar, duke paraqitur ankim në lidhje me këtë pikë bashkë me vendimin përfundimtar, do ti kishte dhënë mundësi Gjykatës së Apelit për administrimin e kësaj prove nëpërmjet riçeljes së hetimit gjyqësor, ose duke kthyer çështjen për rishqyrtim në shkallë të parë.

**100.** Funksioni i gjykatës është dhënia e drejtësisë nëpërmjet një gjykimi të pavarur dhe të paanshëm. Diskrecioni i gjykatës për marrjen e provave kryesisht, sipas parashikimeve të neneve 366 dhe 367 të K.Pr.Penale nuk bazohet thjesht dhe vetëm në pavarësinë e gjykatës për të vlerësuar marrjen ose jo të një prove, por është e lidhur ngushtësisht me natyrën e gjykimit, kushtet që duhet të provohen sipas objektit të gjykimit, dhe sidomos me paanësinë e gjykatës në shqyrtimin dhe dhënien e vendimit.

**101.** Në të njëjtën linjë edhe funksioni i prokurorit në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të kërkesave penale gjatë kësaj faze, nuk është diskrecional në mënyrë abstrakte por ai është ngushtësisht i lidhur me natyrën e gjykimit dhe plotësimin e kriterëve ligjore të gjykimit si dhe me paanësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të veta si përfaqësues i interesit publik pa u bërë palë me kërkuesin.

**102.** Edhe pretendimet e tjera të magjistratit se potencialisht ekzekutimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë për afatin 1 vit e 8 (tetë) muaj do kishte përfunduar, para se të përfundonte gjykimi pranë gjykatës së apelit, çka do të thotë se ankimimi do të ishte formal, pa formuar asnjë pasojë





juridike, nuk përbën argument ligjor dhe nuk justifikon dhe as shmang prokurorin nga detyrimi për të përbushur funksionet e veta gjatë gjykimit të kësaj çështje.

**B. MOSPËRMBUSHJA E PAJUSTIFIKUAR E FUNKSIONEVE GJATË GJYKIMIT DHE MOSVEPRIME E SJELLJE TË MAGJISTRATIT QË KA SJELLË PËRFITIM TË PADREJTË PËR PALËT NË NJË PROCES GJYQËSOR NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN, NË ÇËSHTJET ME NR. VENDIMI 82 AKTI, DATË 14.02.2018 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË DHE NR. VENDIMI 463 AKTI, DATË 21.11.2018 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË.**


103. Nga analiza ligjore e fakteve të pranuar, bazuar në provat e marra gjatë hetimit, rezulton se magjistrati ka kryer mos përbushje të pajustificuar dhe të përsëritur të funksioneve gjatë gjykimit si dhe mosveprim/sjellje që kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin në çështjet me nr. vendimi 82 akti, datë 14.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nr. 463 akti, datë 21.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

104. Me vendimin nr. 82 akti, datë 14.02.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së të dënuarit H.B.
- Njohjen e ditëve të paraburgimit të të dënuarit nga data e arrestimit të tij nga autoritetet angleze më datë 15.11.2007, deri kur vendimi i gjykatës së apelit Tiranë ka marrë formë të prerë më datë 20.07.2016...[...] (Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.)

105. Me vendimin nr. 23 akti, datë 13.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: “Njohja e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, i dënuar për veprat penale: “Vrasje”; “Vrasje mbetur në tentativë dy herë”; “Plagosje me dashje për të shkakuar lëndim të rëndë trupor”; vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese” parashikuar nga neni 79/dh i K.Penal. Caktimin e dënimit me burgim të përjetshëm për shtetasin shqiptar H.B. Vuajtja e dënimit për të dënuarin të fillojë më datë 15.11.2007.” Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1239, datë 29.06.2015 ka vendosur: “Mospranim ankimi”, për shkak se është bërë nga persona të pa legjitimuar. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 119, datë 28.01.2016 ka vendosur: “Mospranim rekursi”.

106. Me vendimin nr. 382, datë 22.04.2016 të gjyqtarit A.K të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: “Rivendosje në afat të kërkuarit H.B për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 23, datë 13.05.2014”. Ky vendim është bërë objekt shqyrtimi së bashku me vendimin nr. 23, datë 13.05.2014 në përfundim të të cilit, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 23 akti, datë 13.05.2014 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, si vijon: Pranimin e kërkesës. Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, i dënuar për veprat penale: vrasje; vrasje mbetur në tentativë dy herë; plagosje me dashje për të shkakuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76 i K.Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim, për veprën penale të “Vrasjes së mbetur në tentativë” në bazë të nenit 76 dhe 23 të K.Penal caktimin e dënimit me



15 vite burgim, dhe për veprën penale të “Plagosje e rëndë me dashje” në bazë të nenit 88/1 të K.Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit H.B me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007”. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë me nr. 59403-01652-00-2016, datë 16.09.2016, ndërsa ende nuk ka dalë me vendim mbi këtë çështje.

107.Me vendimin nr. 82 akti, datë 14.02.2018 gjykata i ka njohur kërkuesit cilësinë e të parabugosurit për periudhën 15.11.2007 deri kur vendimi i gjykatës së apelit Tiranë ka marrë formë të prerë, më datë 20.07.2016, në kundërshtim me nenin 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, i cili parashikon shprehimisht se: “Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse”, nenin 61, pika 2, të Ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” i cili parashikon se: “Gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendim gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose të amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar” si dhe, në kundërshtim me nenin 52, pika 2, të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Gjykata që ka dhënë vendimin ose gjykata e vendit ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit, ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi dhe, kur e sheh me vend, kontrollon drejtpërdrejt rregullsinë e ekzekutimit”.

108.Në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë të datës 07.09.2016, në zbatim të nenit 22, pika 3, të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, është kryer përlllogaritja e detajuar dhe me periudha përkatëse të kohës së paraburgimit për efekt të vuajtjes së dënimit sipas parashikimit të nenit 57 të K.Penal, si dhe koha e dënimit me burgim të vuajtur në shtetin e huaj për të dënuarin H.B, duke përcaktuar se nga dita e ekstradimit në Shqipëri datë 26.01.2016 dhe në vazhdim i mbeteshin për të kryer edhe 16 vjet 4 muaj dhe 3 ditë burgim.

109.Ndërkohë gjykata pavarësisht përlllogaritjes së kohës së paraburgimit të kryer nga prokurori i ekzekutimit, i ka rinjohur të dënuarit H.B, kohën e paraburgimit e të burgimit në shtetin e huaj, në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave procedurale e materiale penale dhe përkatësisht neni 518, pika 1 dhe 3, të K.Pr.Penale, vendimin unifikues nr. 154/2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, neni 438 i K.Pr.Penale dhe neni 57 i Kodit Penal, neni 52, pika 2 të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” duke sjellë përfitim të padrejtë për të dënuarin H.B. Magjistrati nën hetim disiplinor, i pranishëm në gjykim nuk rezulton të ketë shtruar për diskutim asnjë çështje ligjore lidhur me objektin e kërkesës dhe prania e tij në seancë ka qenë thjesht formale. Ai ka dakordësuar çdo lloj kërkesë të të dënuarit, në shkelje të parimit të paanshmërisë dhe ligjshmërisë në pjesëmarrjen e tij si përfaqësues i interesit publik në çështje, ndërsa nuk ka përmbushur funksionin e vet atë të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale, parashikuar nga neni 518, pika 1 dhe 3 të K. Pr.Penale.

110.Sa më sipër rezulton se organi i akuzës, ndonëse ka pasur tashmë një qëndrim në lidhje me përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit deri më datë 26.01.2016, qëndrim i cili shprehet



nëpërmjet urdhrit të ekzekutimit të datës 07.09.2016, dhe ndonëse ky akt (urdhër ekzekutimi) ka qenë pjesë e dosjes, prokurori Bujar Memia nuk rezulton t'i jetë referuar si për tu dakordësuar me arsyetimin e tij, për sa kohë që ky akt nuk ishte ndryshuar/shfuqizuar apo për të pasur një arsyetim kundër nga ajo sa arsyetohet në urdhrin e ekzekutimit.


**111.**Bazuar në nenin 514 të K.Pr.Penale, që vendimi penal i huaj të njihet në shtetin shqiptar, duhet që ai të ketë marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë. Pra vendimet e gjykatave shqiptare të njohjes nuk janë vendime të reja dënimi për të dënuarit, por ato vetëm njohin vendimin e huaj të formës së prerë për efekt ekzekutimi të vendimit në shtetin shqiptar. Në nenin 514, pika 1, shkronja “a”, të K.Pr.Penale parashikon se vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë.

**112.**Në vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 Gjykata e Apelit Tiranë ka konfirmuar se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rastet e ndalimeve të parashikuara në nenin 514 të K.Pr.Penale për njohje të vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, vendim i cili i plotëson të gjitha kushtet ligjore për t'u njohur.

**113.**Nga provat e administruara gjatë procedimit disiplinor referuar fakteve të konstatuara, vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1016, datë 20.07.2016 si dhe akteve të dosjes që i përket vendimit nr. 82, datë 14.02.2018, provohet se vendimi nr. 82 akti, i gjykatës është marrë në shkelje të vendimit unifikues nr. 154/2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe për rrjedhojë në shkelje të dispozitës procedurale të nenit 438 të K.Pr.Penale, vendim i cili ka unifikuar qëndrimin se: “ *...[...]. Është vendimi i huaj ai që vihet në ekzekutim nëpërmjet një vendimi njohës të gjykatës shqiptare. Pra nuk kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës shqiptare që vihet në ekzekutim, por me një vendim të një gjykate të huaj që ekzekutohet në përputhje me legjislacionin shqiptar....[...].vendimi i gjykatës shqiptare që bën konvertimin nuk është një vendim i ri dhe se gjykata shqiptare nuk e shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e shtetit dënues*”.

**114.**Bazuar në këtë vendim unifikues nr. 154/2000, si dhe në nenin 514 të K.Pr.Penale, vendimi i gjykatës së apelit nr. 1016, datë 20.07.2016 nuk është vendim dënimi që vihet në ekzekutim që llogaritja e paraburgimit të kryhet deri në marrjen formë të prerë të këtij vendimi, por nëpërmjet tij vihet në ekzekutim vendimi i një gjykate të huaj dhe konkretisht vendimit nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Pra vendimi i huaj ka marrë formë të prerë më 14.10.2008, dhe nga ky moment e në vijim, kërkuesi ka pasur cilësinë e të dënuarit.

**115.**Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë vërehet se gjykata shqiptare, kur bën njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, nuk shqyrton çështjen në themel dhe nuk verifikon provat e administruara nga gjykata e huaj. Ajo vetëm verifikon nëse ekziston ndonjë nga kushtet për mosnjohjen e vendimit të huaj dhe më tej konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj me një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar. Për më tepër, referuar parashikimeve të nenit 518 i Kodit të Procedurës Penale bie pretendimi i magjistratit se, cilësinë e të dënuarit, H.B e ka fituar me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë



dhe nisur nga ky fakt, ligji shqiptar dhe praktika gjyqësore është tepër eksplicite në lidhje me këtë moment. Konkretisht në nenin 518/1 të K.Pr.Penale përcaktohet se: “*Pasi janë njohur vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar*” dhe më pas pika 3 e kësaj dispozite përcakton në mënyrë të shprehur se: “*Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj llogaritet për efektet e ekzekutimit*”. E gjitha kjo të shpie në përfundimin se, pozitën e të dënuarit ai e ka që në momentin kur vendimi në shtetin e huaj ka marrë formë të prerë, pra nga data 14.10.2008.

**116.**Bazuar në sa më sipër, nga ana e Këshillit gjenden të pabazuara pretendimet e magjistratit subjekt procedimi, se vendimi ka marrë formë të prerë më datë 20.07.2016 dhe se deri në këtë moment kërkuesi ka pasur cilësinë e të paraburgosurit. Nëse do të vlente ky argument, atëherë nuk do të ishim para rasteve të njohjes së vendimit penal të huaj sipas parashikimeve të nenit 514 të K.Pr.Penale sikundërse rezulton të jetë rasti objekt hetimi.

**117.**Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore dhe fakteve për të cilat edhe magjistrati subjekt procedimi ka pasur dijeni në aktet për shqyrtim, gjykata i ka njohur kërkuesit H.B në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara, duke ju llogaritur si kohë paraburgimi një periudhë prej mbi 4 vite 1 muaj dhe 23 ditë, e cila është pjesë e kohës totale të paraburgimit të njohur prej 4 vite 5 muaj e 8 ditë, ku përfshihet pjesa e njohur me vendimin nr. 281 akti, datë 03.05.2018<sup>12</sup> pasqyruar në dinamikën e vuajtjes së dënimit, e cila ndodhet në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. 26 akti, datë 22.02.2019, me qëllim rritjen fiktive të kohës së dënimit për arritjen e synimit final atë të lirimit të të dënuarit. Prokurori kishte për detyrë të kontrollonte dinamikën e vuajtjes së dënimit dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore ka shprehur dakortësinë lidhur me mënyrën e përlllogaritjes të bërë nga gjykata. Pavarësisht kësaj prokurori i çështjes nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, duke e konsideruar të drejtë dhe ligjor disponimin e gjykatës.

**118.**Fakti i pretenduar nga magjistrati në parashtrimet e veta se vendimmarrja e gjykatës në këtë rast është në të njëjtën linjë edhe me praktikën e gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore nuk është shkak që provon mungesën e shkeljes disiplinore nga ana e tij në mos përmbushjen e funksioneve gjatë dhe pas gjykimit të çështjes me nr. 82, datë 14.02.2018. Prokurori nuk ka përmbushur funksionin e vet, sikundërse është mundësia e kontrollit gjyqësor të vendimmarrjes së gjykatës nga një gjykatë më e lartë, në funksion të miradministrimit të drejtësisë. Sigurisht që kërkuesi nuk ka interes të ankimojë një vendim të dhënë në favor të tij, ndërsa pala tjetër në proces që është prokurori i cili përfaqëson interesin publik ka detyrimin të marrë masa për të balancuar rëndësinë e këtij interesi duke vepruar në mënyrë të paanshme dhe në zbatim të ligjit. Rezulton se qëndrimi i prokurorit në seancë është pasiv, ndërsa pas gjykimit rezulton që me mosveprimin e tij, duke mos ushtruar ankim ndaj një vendimi të tillë, të ketë ndikuar në përfitimin e padrejtë të kërkuesit H.B., në kundërshtim me ligjin. Fakti që vendimi nuk është ankimuar nga ana e prokurorit, ka garantuar përfitimin e padrejtë të kërkuesit H.B., në kundërshtim me ligjin si kohë paraburgimi një periudhë prej 4 vite 5 muaj dhe 8 ditë<sup>13</sup>.

**119.**Në vendimin nr. 281, datë 03.05.2018<sup>14</sup>, të paraqitur nga subjekti në mbështetje të këtij pretendimi, rezulton se të dënuarit H.B i është njohur si periudhë paraburgimi koha nga data e arrestimit nga autoritetet Daneze 04.09.2007 deri në transferimin e tij në shtetin Anglez datë 14.11.2007, vendimmarrje e cila shtrihet në periudhën para datës 15.11.2007 dhe nuk ka lidhje me

<sup>12</sup> Në këtë periudhë përfshihet edhe koha e paraburgimit të njohur të dënuarit me vendimin nr. 281 datë 03.05.2018, nga data 04.09.2007- 14.11.2007 (2 muaj dhe 10 ditë kohë paraburgimi = 3 muaj dhe 15 dite burgim)

<sup>13</sup> Shiko dinamikën e vuajtjes së dënimit të ndodhur në dosjen me nr 26 akti datë 22.02.2019 për lirimin e të dënuarit H.B.

<sup>14</sup> Dhënë nga gjyqtare N.P e cila rezulton se nuk gëzon statusin e magjistratit për shkak të daljes në pension.



periudhën pas marrjes formë të prerë të vendimit të dënimit të gjykatës së huaj më datë 14.10.2008, dhe që ka qenë objekt vlerësimi dhe shqyrtimi në këtë gjykim.

**120.** Lidhur me analizën e provueshmërisë së shkeljes vlen i njëjti argument ligjor i parashtruar në pikat 93-97 të këtij vendimi.

**121. Me vendimin nr. 463 akti, datë 21.11.2018,** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit H.B.
- Njohjen e amnistisë për kërkuarin H.B duke i ulur 1 vit nga dënimi, sipas ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”..[...] (Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar).Konstatohet se gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar me prani të përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia i pranishëm në 3 seanca e fundit gjyqësore në datat 04.10.2018, 14.11.2018, 21.11.2018.

**122.** Nga provat e marra në kuadër të procedimit disiplinor rezulton se me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur: “Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T20087287 datë 14.10.2008 të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B, i dënuar për veprat penale: vrasje, vrasje mbetur në tentativë dy herë, plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76 i K.Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim, për veprën penale të “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të K.Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim, për veprën penale të “Plagosje e rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të K.Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit H.B me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007.”

**123.** Sipas këtij vendimi njohje, i dënuari H.B, është dënuar për vepra penale të cilat sipas legjislacionit penal shqiptar korrespondojnë me veprat penale “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të K.Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim, për veprën penale të “Plagosje e rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të K.Penal dënimin e tij me 10 vite burgim.

**124.** Neni 61, pika 2 e Ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” parashikon shprehimisht se: “Gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendim gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose të amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar”. Në legjislacionin shqiptar, përkatësisht në nenin 4, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 141, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie” [15] “Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë” është parashikuar përkatësisht se: “Pavarësisht nga parashikimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:...[...]... b) krime kundër jetës, të kryera me dashje të parashikuara në nenet 76,..[...]...c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit të parashikuara nga nenet ..[...]...88...[...]...të Kodit Penal.

**125.** Nga provat e administruara gjatë procedimit disiplinor rezulton se me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë pas konvertimit të dënimit, veprat penale të cilat është dënuar shtetasi H.B, janë ato të “Vrasjes”, “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe “Plagosje e rëndë me dashje” të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të K.Penal, dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal është dënuar me 25 vite burgim.

**126.** Në Ligjin nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie” qenia i dënuar për këto vepra penale për të cilat është dënuar edhe shtetasi H.B, janë kategorizuar si kriter ndalues për përfitim amnistie, sipas këtij ligji. Neni 5, pika 1, shkronja “b”, e Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, në të cilin gjykata është bazuar në marrjen e vendimit nr. 463, datë 21.11.2018 ka parashikuar shprehimisht se: “Të

[15] Publikuar në Fletore Zyrtare nr. 255, datë 30.12.2016.

*gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra.”*

127. Nga aktet e administruara gjatë procedimit disiplinor, rezulton se vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 është marrë në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor pasi nuk rezulton që i dënuari H.B të plotësonte kushtin e parashikuar në ligj. Në kohën e dhënies së vendimit nuk rezulton që këtij të dënuari t'i kishte mbetur pa vuajtur 1 vit nga dënimi i dhënë me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 prej 25 vite burgim.

128. Në kohën që gjykata, në prani të magjistratit nën hetim disiplinor Bujar Memia ka disponuar për lirim të dënuarit H.B me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 (*pas disa muajsh nga dhënia e vendimit nr. 463/2018*) sipas dispozitivit të vendimit, të dënuarit H.B i kishin mbetur pavuajtur nga dënimi dhe 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë.

129. Me anë të dhënies së vendimit nr. 463, datë 21.11.2018 gjykata dukshëm në kundërshtim me parashikimet e neneve 4 dhe 5 të Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, ka sjellë një përfitim të padrejtë për kërkuesin H.B me uljen 1 vit të dënimit me burgim. Ky përfitim rezulton të jetë pasqyruar në dinamikën e vuajtjes së dënimit të administruar dhe i përfshirë në kohën totale të vuajtjes së dënimit, mbi bazën e të cilit e njëjta gjykata ka disponuar në vijim me dhënien e vendimit për lirim të dënuarit H.B me nr. 26 akti, datë 22.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me objekt “*Lirimin me kusht të kërkuesit (të dënuarit) H.B*”, ku përfaqësues i organit të akuzës rezulton të jetë sërish magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia.

130. Fakti i pretenduar nga magjistrati Bujar Memia në parashtrimet e veta se vendimmarrja e gjykatës është në të njëjtën linjë edhe me praktikën e gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore<sup>16</sup> nuk është shkak që provon mungesën e shkeljes disiplinore nga ana e tij në mos ankimimin e vendimit nr. 463, datë 21.11.2018.

131. Nga ana tjetër vendimi nr. 79, datë 25.05.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të përdorur si referencë nga magjistrati në parashtrimet e veta, ka lejuar amnisti për një nga veprat penale për të cilat ishte dënuar kërkuesi e cila nuk përfshihej në kategorinë e veprave penale të parashikuara si ndaluese për përfitim amnistie dhe kolegji ka interpretuar nenin 55 të K.Penal për bashkimin e dënimeve, në një kohë që rasti i të dënuarit H.B, është i ndryshëm pasi të dy veprat penale për të cilat ai është dënuar (neni 76, dhe 88 i K.Penal) hyjnë në kategorinë e veprave penale për të cilat parashikohet kriter ndalues përfitimi me amnisti sipas nenit 4 të Ligjit nr. 141/2016.

132. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me të njëjtën përbërje, ka pasur disa vendimmarrje të njëpasnjëshme për këtë çështje përkatësisht në vendimet me nr. 82, datë 07.06.2017, nr. 83, datë 07.06.2017 dhe nr. 84, datë 07.06.2017, vendime këto të cilat janë dhënë para vendimit nr. 463, datë 21.11.2018 objekt hetimi disiplinor, në të cilat ka mbajtur qëndrim konstant dhe vijues se: “[...]...Ky Kolegj arrin në përfundimin se me shprehjen “1 vit të mbetur”, ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i referohet periudhës përfundimtare të mbetur pa vuajtur nga ana e kategorisë së personave dënuar të parashikuar nga neni 4 i ligjit në fjalë, dhe kjo periudhë është e vetmja kohë vuajtjeje dënimit që duhet t'i ketë mbetur të dënuarit, si kusht që të përfitojë përjashtimin nga dënimi. Pra, kategoria e personave të parashikuar në nenin 4 të këtij ligji është kategoria e personave, në rastin konkret burra, që iu ka mbetur pavuajtur një vit, pasi ndryshe nuk do të kishte

<sup>16</sup> Shiko: (i) vendimin nr. 940 akti, datë 05.12.2018 të gjyqtarit A.M i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) vendimin 157 akti, datë 11.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) vendimin nr.79, datë 25.05.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

*kuptim termi “i mbetur”, shtuar siç duket në seancë plenare, por e pa përmendur në projektligjin e parashtruar për miratim nga ana e Kuvendit. Prandaj në këto kushte, zbatimi i nenit 4 i ligjit nr.154/2015, do të zbatohet vetëm për ata persona të cilëve u ka mbetur pa vuajtur, përkatësisht edhe 1,5 vjet (të dënuara) apo 1 vit (të dënuar) nga përfundimi i vuajtjes së plotë të dënimit të dhënë ndaj tyre, vetëm me plotësimin e këtij kushti ata do të mund të përfitojnë përjashtimin e pjesshëm nga dënimi, sipas përkatësisë së tyre në shkronjën “a” apo shkronjën “b” të nenit 4 të ligjit nr.154/2015...[...].*

**133.**Në çështjet e mësipërme, vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta për përfitim amnistie për të dënuarit, janë ndryshuar nga Gjykata e Lartë pikërisht mbi bazë rekursi të ushtruar nga prokurori, gjë e cila nuk ka ndodhur nga magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia në rastin e të dënuarit H.B., duke sjellë marrjen formë të prerë të vendimit nr. 463, datë 21.11.2018 dhe përfitimin e padrejtë me uljen 1 vit të dënimit të të dënuarit H.B. në kundërshtim me Ligjin nr. 141/2016.

**134.**Prokurori Bujar Memia ka qenë i pranishëm edhe në gjykimin e çështjes me nr. vendimi 217 akti, datë 06.11.2017 të të njëjtit kërkues H.B. me tjetër trupë gjykuese, me objekt kërkimi “Njohje e përfitimit nga amnistia”, në të cilin gjatë gjykimin e ka lënë në çmim të gjykatës, ndërsa nuk rezultoi të ketë ushtruar ankim ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për përfitim amnistie të kërkuesit H.B sipas Ligjit nr. 22/2014. Referuar arsytimit të këtij vendimi gjyqësor rezultoi se shkak i rrëzimit të kërkesës është mosplotësimi i asnjë prej kriterëve të parashikuara në këtë ligj si atyre lejuese dhe ndaluese, të cilat për analogji janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 141/2016. Gjykata në këtë rast vetëm ka specifikuar se në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 22/2014, nuk ka pasur cilësinë e të dënuarit, por kjo pasi nuk ishte dhënë ende vendimi nr. 1016 datë 20.07.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë, për njohjen e vendimit penal të huaj, ndërsa magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia me keqdashje e interpreton këtë vendim se sipas tij i dënuari ka fituar këtë cilësi në datë 20.07.2016 dhe për rrjedhojë para kësaj periudhe ka pasur cilësinë e të paraburgosurit, me qëllim për të justifikuar mos përmbushjen e funksioneve të tij gjatë gjykimin të çështjes tjetër me nr. 82 akti, datë 14.02.2018 “Për njohjen e kohës së paraburgimi” .

**135.**Dukshëm në dy çështje të të njëjtit kërkues H.B., magjistrati Bujar Memia ka mbajtur 2 qëndrime totalisht të ndryshme për të njëjtat çështje ligjore, duke provuar se me dashje ka ndryshuar qëndrimin e parë të tij në vendimin nr. 271, datë 06.11.2017, tashmë në favor të të dënuarit H.B., duke i sjellë këtij të fundit përfitim të padrejtë dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 141/2016, nëpërmjet mos përmbushjes së funksionit të magjistratit atë të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore si përfaqësues i interesit publik , detyrim i parashikuar në nenin 53 të Ligjit nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, referuar qëndrimin të mbajtur nga ana e tij në seancë, si dhe mos ushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. 463 akti, datë 21.11.2018 duke sjellë marrjen formë të prerë të tij.

**136.**Lidhur me analizën e provueshmërisë së shkeljes vlen i njëjti argument ligjor i parashtruar në pikat 93-97 të këtij Relacioni, shkelje profesionale të cilat dëmtojnë rëndë pozitën dhe figurën e prokurorit

**C. MOSPËRMBUSHJA E PAJUSTIFIKUAR E FUNKSIONEVE GJATË GJYKIMIT, MOSVEPRIME E SJELLJE TË MAGJISTRATIT QË KA SJELLË PËRFITIM TË PADREJTË PËR PALËT NË NJË PROCES GJYQËSOR NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN SI DHE MOSRESPEKTIM TË RËNDË DHE TË VAZHDUAR TË LEGJISLACIONIT MATERIAL DHE PROCEDURAL PENAL, NË ÇËSHTJEN ME NR.**

**VENDIMI 26 AKTI, DATË 22.02.2019 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KRUJË.**

137. Nga analiza ligjore e fakteve të pranuar, bazuar në provat e marra gjatë procedimit disiplinor, rezulton se magjistrati nën hetim disiplinor ka mos përmbushje të pajustificuar të funksioneve gjatë gjykimit dhe dhënies së vendimit, si dhe mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal në çështje me nr. 26 akti, datë 22.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

138. Me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit (të dënuarit) H.B.
- Lirimin me kusht të kërkuarit (të dënuarit) H.B për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë, për një kohë prove prej 5 vjetësh.
- Në zbatim të nenit 60 pika 1 e Kodit Penal i dënuari H.B të ushtrojë një veprimtari profesionale referuar kontratës së punës pranë personit fizik dhe referuar nenit 60 pika 9 e Kodit Penal, i dënuari H.B përgjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar.
- Urdhërohet i dënuari H.B të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
- Urdhërohet lirimi i tij nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.
- Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi...[...]

139. Më datë 22.02.2019 prokurori Bujar Memia ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal nr. 26 akti, datë 22.02.2019 në të cilën është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i të dënuarit H.B, mbi bazën e të cilit është nxjerrë Urdhër Lirimi nr. 15 prot. datë 22.02.2019.

140. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Për rrjedhojë më datë 13.03.2019, prokurori Bujar Memia ka nxjerrë urdhrin për zbatimin e vendimit nr. 26 akti, datë 22.02.2019.

141. Konstatohet se kjo çështje është regjistruar në datën 07.01.2019, ndërsa gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar me prani të përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia i pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara në datat: 17.01.2019, 24.01.2019, 07.02.2019, 15.02.2019, 21.02.2019, 22.02.2019.

142. Në seancën e parë të datës 17.01.2019, gjykata ka bërë me dije palët, përfshirë prokurorin Bujar Memia, se kishte vendosur paraprakisht para seancës së parë gjyqësore të njoftonte Zyrën e Shërbimit të Provës Krujë, si dhe Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e dëshmisë së penaltetit të kërkuarit. Të dy këto veprime procedurale janë kryer nga gjykata në shkelje të parashikimeve të neneve 356, 367 të K.Pr.Penale, ndërsa nuk janë ekzekutuar dhe gjykata është detyruar t'i rikërkojë pranë institucioneve përkatëse. Vihet re një rol tepër pasiv i prokurorit Bujar Memia në lidhje me respektimin e procedurës nga ana e gjykatës në marrjen e provave, që si rregull përfundon marrja e provave të kërkuara nga palët e në vijim investohet gjykata kryesisht në marrjen e tyre. Prokurori nuk ka shfaqur asnjë pretendim lidhur me to.

143. Në seancën e datës 15.02.2019 palët kanë kërkuar kohë të njihen me Raportin e Shërbimit të Provës. Në seancën e datës 21.02.2019 prokurori Bujar Memia ka kërkuar kohë për të njohur me konkluzionet e avokatit të të dënuarit dhe me provat. Seanca është shtyrë ditën e nesërme për të paraqitur prokurori konkluzionet me shkrim. Në dosje nuk rezulton të jenë paraqitur konkluzione me shkrim nga ana e tij ndërsa ato janë formuluar verbalisht në seancën e datës 22.02.2019. Në këtë seancë magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia ka parashtruar para gjykatës se:



...[...]. Konstatohet që plotësohen kriteret ligjore me aplikim vuajtje e  $\frac{3}{4}$  të dënimit siç e kërkon dispozita neni 64 pasi kanë ngelur vetëm 5 vite e 5 muaj dhe 19 ditë, sipas raportit paraqitur nga I.E.V.P dhe raportit të vlerësimit të shërbimit të provës. Në vështrim të kërkesave ligjore të vendimit unifikues të kolegjeve të bashkuara të gjykatës së lartë konstatohet që është kontratë individuale pune, nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore konstatohet se i vetmi dënim që ai po vuan në I.E.V.P Fushë-Krujë, duke marrë parasysh certifikatën familjare dhe vërtetime të aspektit shëndetësor, kërkuesi H.B, është bashkë me babin dhe nënën e tij, të cilët të moshuar dhe me dokumente shëndetësore provohet që janë me probleme shëndetësore, pra e kanë të nevojshme praninë e të dënuarit. Sa i përket raportit paraqitur nga zyra vendore e shërbimit të provës Krujë përcakton në bazë të gjitha analizave, pyetje, provave të marra gjatë gjykimit ka provuar se personi i dënuar, mundësia e tij për ri integrim është evidente. Edhe gjatë pyetjes që i bëri seancën e kaluar e nderuara gjykatë tha që është e mundshme pavarësisht se e ka lënë në çmim të gjykatës, nga pikëpamja sociale rrezikshmëria e këtij personi është ulur, për sa i përket faktit problematike që mund të jetë, nëse është masa prej 5 vjet e 5 muaj që është masë e madhe, nuk është kriter që mund të pretendojmë që s' duhet marrë parasysh, kriteri ligjor  $\frac{3}{4}$  është përmbushur, edhe kjo nëse ka marrëveshje pajtimi apo jo dhe kjo nuk është kriter ligjor që duhet marrë parasysh, mendoj se plotësohen të gjitha kushtet sipas objektit paraqitur nga i dënuari, por duke qenë se jemi organ procedues, për mos sugjestionuar gjykatën ne mendojmë ta lëmë në çmim të gjykatës".

144. Ndërkohë nga aktet e administruara gjatë procedimit disiplinor rezulton se me vendimin nr.81 regj datë 18.01.2019 Gjykata e Shkallës së Parë Krujë, me gjyqtare E.H ka vendosur "Uljen e dënimit për kërkuesin H.B në masën 90 ditë, për periudhën kohore viti 2007". Konstatohet se kjo çështje është regjistruar në datën 08.01.2019, pra vetëm 1 ditë pasi ishte regjistruar kërkesa mbi bazën e së cilës është marrë vendimi nr.26 akti, datë 22.02.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

145. Sipas analizës së bërë nga ILD nga faktet e konstatuara gjatë hetimit thuhet se vendimi nr.26, datë 22.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është marrë nga gjykata në mosrespektim të rëndë të nenit 64, paragrafi 1, ndarja e tretë e Kodit Penal për shkak të mosplotësimit të kushtit parësor për të përfutur lirim me kusht, ai i periudhës efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari H.B prej  $\frac{3}{4}$  si dhe, shkeljen e kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 2 i Kodit Penal, i cili parashikon shprehimisht se: "Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje". Gjykata në vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 ka arsyetuar se duke ju referuar kësaj dinamike, i dënuari ka vuajtur gjithsej 19 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë burgim, dhe i mbeten për të vuajtur 5 vjet 6 muaj dhe 11 ditë burgim. Konstatohet se  $\frac{3}{4}$  e dënimit prej 25 vite burgim për këtë kategori të dënuarish, rezulton të jetë 18 vjet dhe 9 muaj, ndërsa  $\frac{1}{4}$  rezulton të jetë 6 vjet dhe 3 muaj. Prokurori megjithëse është njohur me këtë arsytim të gjykatës, me këtë përlllogaritje të dënimit nga e cila rezulton se nuk plotësohet periudha efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari H.B prej  $\frac{3}{4}$ , llogaritje në të cilën është përfshirë në kundërshtim me kriterin ndalues të parashikuar nga neni 64 i K.Penal edhe periudha e përfutur me amnisti, sërish nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, duke bërë që ai të marrë formë të prerë, në mosrespektim të rëndë të dispozitave ndaluese të Kodit Penal.

146. Në fakt referuar dokumentit "Dinamika e vuajtjes së dënimit për të dënuarin" nr. Ekstra. prot datë 24.01.2019 përgatitur nga IEVP Fushë-Krujë, për llogari të këtij procesi gjyqësor, rezulton se më datë 24.01.2019 i dënuari H.B kishte vuajtur 19 vite 5 muaj e 19 ditë dhe se i mbeteshin për të vuajtur 5 vite 6 muaj e 11 ditë. Në masën e vuajtur të dënimit ishte përlllogaritur edhe periudha e njohur me vendim gjykate si e përfutur nga ligji "Për amnistinë" nr.144/2016. Duhet theksuar në masën e dënimit të vuajtur, nga I.E.V.P nuk ishte përlllogaritur ulja e dënimit prej 90 ditësh e përfutur me vendimin nr.81 datë 18.01.2019, pasi vendimi më datë 24.01.2019 nuk kishte marrë ende formë të prerë. Gjithashtu deri më datën 22.02.2019, datë në të cilën është shpallur vendimi


nr.26 akti duhet të llogaritet edhe periudha e vuajtur nga data 24.01.2019, deri në këtë datë, periudhë e cila rezulton të jetë gjithsej 29 ditë. Nisur nga sa më sipër rezulton se më datë 22.02.2019, i dënuari H.B, kishte vuajtur nga dënimi i dhënë 19 vite 9 muaj e 18 ditë, duke i zbritur kësaj periudhe, kohën e përfitur në zbatim të gabuar nga ana e gjykatës të ligjit “Për amnistinë” nr.144/2016, rezulton se koha e vuajtur e dënimit më datë 22.02.2019 është 18 vite 9 muaj e 18 ditë, pra masa e vuajtur e dënimit është më e madhe se  $\frac{3}{4}$  e dënimit prej 25 vitesh burgim.

147.Ndërkohë rezulton se vendimin nr. 81 datë 18.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është marrë në shkelje të ligjit. Me vendimin nr. 1016, date 20.07.2016., të Gjykatës së Apelit Tiranë, është përcaktuar koha e fillimit të vuajtjes së dënimit nga data 15.11.2007. Ndërkohë konstatohet se me vendimin nr. 81, date 18.01.2019 gjyqtarja E.H, në kundërshtim me disponimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë i ka ulur dënimin të dënuarit në masën 90 ditë për llogari të vitit 2007 duke zbatuar nenin 63 të Ligjit nr. 8328/1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar. Ky disponim është në kundërshtim me përcaktimin e këtij ligji, si dhe parashikimet e 57 të Kodit Penal, nenit 438, 518, pika 1 dhe nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale, nenit 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, date 10.6.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për transferimin e personave të dënuar", nenit 52, paragrafi 2, të ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 154/2000. I dënuari H.B ka qenë i paraburgosur nga data 15.11.2007, deri me datë 14.10.2008, kohë kur vendimi penal i huaj ka marrë formë të prerë dhe cilësinë e të dënuarit e ka marrë nga data 14.10.2008 e në vijim, ndërkohë që ulja e dënimit është bere për një periudhe kur ai nuk ka qenë fare i paraburgosur, ose nuk ka pasur cilësinë e të dënuarit, por atë të të pandehurit, çka e bën vendimin 81 datë 18.01.2019, një vendim të marrë në kundërshtim të hapur me ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, i ndryshuar, duke sjelle një përfitim të pa drejtë për të dënuarin H.B.

148.Në kushte ku vendimi nr. 81 date 18.01.2019 i gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë, është marrë në shkelje të ligjit, prokurori Bujar Memia, në ushtrim të funksioneve të tij si prokuror duhet të kishte kërkuar, përjashtimin e gjyqtarës E.H nga gjykimi i mëtejshëm i kërkesës, pasi dukshëm, kjo gjykatë nuk ishte një gjykatë e paanshme, kjo lidhur edhe me vendime të tjera të marra nga e njëjta gjyqtare për të dënuarin H.B në shkelje të ligjit<sup>17</sup>. Pavarësisht se vendimi nr.81 ka qenë pjesë e fashikullit të gjykimit dhe ka marrë formë të prerë gjatë gjykimit, nga ana e prokurorit Bujar Memia, në asnjë moment nuk janë ngritur pretendime në lidhje me këtë vendim apo paanshmërinë e gjykatës. **Ky mosveprim nga ana e prokurorit përbën mospërmbushje të pajustificuar të funksionit, ndërkohë që në bazë të nenit 18 dhe germës “ë” të pikës 1 të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale duhet të kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarës, nga gjykimi i mëtejshëm i kërkesës penale dhe sigurisht që qëndrimi i tij gjatë shqyrtimit të çështjes nuk mund të ishte pasiv, nisur nga predispozita e gjykatës për të favorizuar të dënuarin me vendimmarrjet e saj.**

149.Pavarësisht sa më sipër, duhet theksuar se lirimi para kohe me kusht është një nga alternativat e dënimit me burgim. Në mënyrë që gjykata të vendosë zbatimin e këtij instituti, është e nevojshme që të plotësohen disa kushte ose kërkesa me karakter ndalues dhe objektiv si koha e vuajtjes së dënimit dhe mos përfshirja në këtë kohë, pjesën e përfitur nga i dënuari me amnisti apo falje, të cilat janë të parashikuara shprehimisht nga ligji penal. Me plotësimin me sukses të këtyre kërkesave (kushteve), meqenëse lirimi me kusht është një alternativë e vuajtjes së dënimit, i dënuari përjashtohet nga pjesa e vuajtjes së dënimit të mbetur, duke përfitur kështu lirinë e plotë.

<sup>17</sup> Shiko vendimet nr.463 datë 21.11.2018, nr.85 datë 25.05.2017, nr.82 datë 14.02.2018



**150.** Nga provat e administruara gjatë procedimit disiplinor si dinamika e vuajtjes së dënimit me nr. ekstra prot., datë 24.01.2019 të ndodhur në dosje dhe me të cilën magjistrati Bujar Memia është njohur në seancën e datës 21.02.2019, gjatë administrimit të provave shkresore, rezulton se i dënuari H.B është dënuar me 25 vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të K.Penal, duke u pasqyruar fakti se nga dënimi i dhënë ka kryer gjithsej 19 vjet 5 muaj dhe 19 ditë, në të cilën janë përfshirë: (i) masa e dënimit të vuajtur fizikisht; (ii) koha e fituar me paraburgim sipas vendimeve gjyqësore përkatëse; (iii) uljet e dënimit të përfituara me vendimet respektive; (iv) masa e përfituar me aktivizim për punë kryer; si dhe (v) periudha 1 vjeçare e përfituar me amnisti sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, dhënë me vendimin nr. 463, datë 21.11.2018.

**151.** Pjesë e akteve me të cilat është njohur prokurori Bujar Memia në këtë seancë ka qenë edhe vendimi nr. 85, datë 25.05.2017 i dhënë nga e njëjta gjykatë në favor të kërkuesit H.B., me anë të të cilit të dënuarit H.B, i është njohur periudhë dënimi nga data 14.10.2008- 25.05.2017, pra momenti i dënimit të tij datë 14.10.2008 nga autoriteti gjyqësor i huaj, Gjykata e Kurorës Snaresbook Angli, njohur me vendimin nr. 23, datë 13.05.2014, deri në datë 25.05.2017, kohë e dhënies së vendimit nr. 85 akti datë 25.05.2017. Me anë të këtij vendimi gjykata i ka ulur dënimin 24 muaj, i cili është realizuar me paraqitjen nga i dënuari të vetëm një kërkesë me objekt ulje dënimi, në një kohë që referuar parashikimit të legjislacionit të brendshëm, nenit 63 të Ligjit nr. 8328/2008, në këtë periudhë i dënuari mund të përfitonte maksimalisht deri në 90 ditë ulje dënimi.

**152.** Pra prokurori ka ardhur tashmë në dijeni të ekzistencës së dy vendimeve gjyqësore nr. 85 datë 25.05.2017 (*në të cilin nuk ka qenë pjesëmarrës*) dhe atë nr. 82, datë 14.02.2018 (*në të cilin ka qenë pjesëmarrës*) me të cilat kërkuesi H.B. ka përfituar ulje dënimi me dy cilësi të ndryshme (*për të njëjtën periudhë kohe*): si i dënuar duke përfituar 2 vjet ulje dënimi, dhe si i paraburgosur duke përfituar rreth 4 vjet 1 muaj dhe 23 ditë. Me anë të këtyre dy vendimeve ka një rritje fiktive të periudhës së dënimit të kryer nga i dënuari H.B në arritjen e objektivit kryesor, atë të lirimimit me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me objekt “*Lirimim me kusht të kërkuesit (të dënuarit) H.B*”. Në të njëjtën frymë rezulton të jetë marrë edhe vendimi nr. 81 date 18.01.2019 i Gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë, pasi në mungesë të uljes së dënimit të dhënë me anë të këtij vendimi, do të ishim në kushte ku i dënuari H.B më datë 22.02.2019 nuk do të plotësonte kriterin e parashikuar nga neni 64 i Kodit penal, ku koha e vuajtur e dënimit të dhënë duhet të ishte e barabartë me  $\frac{3}{4}$ .

**153.** Është konstatuar gjithashtu se në dhënien e këtij vendimi, nga ana e gjykatës si dhe nga prokurori Bujar Memia në ushtrimin e funksioneve të veta në funksion të kontrollit të vendimmarrjes gjyqësore nga një gjykatë më e lartë, me anë të mjetit procedural të ankimit, nuk është zbatuar parashikimi i nenit 64 të K.Penal mbi arsyet e veçanta për të përfituar lirim me kusht, në këndvështrim edhe të vendimit unifikues i Gjykatës së Lartë me Nr. 2, datë 25.05.2015 dhe për rrjedhojë moszbatimi i këtij vendimi ka sjellë dhe mosrespektim të legjislacionit procedural penal mbi detyrimin e gjykatave dhe për zbatim të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, parashikuar në nenin 438/a të K.Pr.Penale.

**154.** Në Vendimin Unifikues Nr. 2, datë 25.05.2015, përveç kërkesave ligjore me natyrë objektive, për akordimin e lirimimit me kusht parashikohen edhe plotësimi i disa kriterëve ligjore me natyrë subjektive, siç janë prania e “*arsyeve të veçanta*”, “*arsyeve të jashtëzakonshme*” apo “*sjelljes shembullore*” të cilat tregojnë se me anë të sjelljes dhe punës, dënimi i dhënë ia ka arritur qëllimit të tij për riedukimin e individit, apo se ka nisur rrugën e sigurt për arritjen e këtij qëllimi paçka se ende nuk e ka përfunduar atë. Arsyet e veçanta të cilat tregojnë rehabilitimin e të dënuarit kërkon një interpretim dhe vlerësim rast pas rasti në bazë të provave që i paraqiten gjykatës.

155. Në Vendimin Unifikues Nr.2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, janë analizuar dhe janë dhënë sqarime të hollësishme në kuptimin dhe zbatimin në praktikë të shprehjes “arsye të veçanta” të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, ku merren parasysh: **(i) natyra e veprave penale të kryera; (ii) qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjarëve të viktimës; (iii) gjendja fizike apo psikologjike e personit të dënuar; (iv) dinamika e sjelljes së të dënuarit në I.E.V.P; (v) kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit.**

156. Referuar këtij vendimi unifikues në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit H.B, gjykata nuk ka vlerësuar ato çështje të përcaktuara në këtë vendim unifikues për evidentimin e shprehjes “arsye të veçanta” duke mos zbatuar plotësimin e këtij kriteri ligjor të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, sikundërse janë: natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale si dhe pendimi i të dënuarit bazuar në të dhëna objektive, ndonjë vepër penale e mëparshme e kryer nga i dënuari, dinamika e sjelljes së të dënuarit, raporti i autoriteteve të I.E.V.P-së, duke u mjaftuar me një konstatim formal të tyre. Këto fakte nuk janë evidentuar gjatë gjykimit dhe as nuk janë arsyetuar në konkluzione përfundimtare nga ana e prokurorit Bujar Memia dhe as pas njohjes me arsyetimin e vendimit gjyqësor (*në formën e një ankimi*), të cilit i mungon arsyetimi dhe analiza në lidhje me konceptin “arsye të veçanta”.

157. Edhe pse në parim, gjykatat kanë një diskrecion të gjerë mbi pranimin ose jo të kërkesës për lirim me kusht, vendimmarrja e tyre mbështetet sidoqoftë në prova objektive të shqyrtuara në gjykim. I njëjti parim vlen edhe për prokurorin si mbrojtës i interesit publik në gjykim dhe mbikëqyrës i ekzekutimit të vendimit të dënimit.

158. Ky konfirmim nuk duhet të jetë thjesht formal, por të karakterizohet nga investimi proaktiv i aktorëve gjykatë dhe prokurori në verifikimin e përshtatshmërisë për të lejuar ri integrimin e të dënuarit në shoqëri për pjesën e mbetur të dënimit të tij. Një rol të rëndësishëm në vlerësimin nga ana e gjykatës të rrethanave të veçanta merr jo vetëm kontakti i drejtpërdrejtë me të dënuarin në seancë gjyqësore, por edhe vlerësimi i sjelljes së tij gjatë kohës që ai ka vuajtur dënimin në institucionin e vuajtjes së dënimit. Ky qëndrim, pavarësisht se është subjektiv për arritjen e një konkluzioni të drejtë, duhet të jetë i bazuar në prova, përderisa i nënshtrohet një procesi shqyrtimi gjyqësor. Sjellja e të dënuarit duhet shqyrtuar dhe analizuar në dinamikë për gjithë dënimin e vuajtur, pasi të vlerësohen të gjitha raportet e sjelljes së periudhës së dënimit të vuajtur. Prokurori me mos ankimimin e tij duhet të çmojë nëse nga konstatimi i gjithë treguesve të sjelljes arrihet qëllimi për edukimin apo risocializimin e këtij të dënuari ose jo si dhe të marrë parasysh të gjitha raportet dhe sjelljen në tërësi të kërkuesit me të gjithë dinamikën e saj gjatë periudhës së dënimit të vuajtur.

159. Duhet theksuar se në rastin konkret i dënuari H.B është transferuar në Shqipëri në datë 26.01.2016, duke pasur një periudhë të vuajtjes së dënimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale shqiptare prej 3 vjet dhe 1 muaj, ndërsa pjesa dërmuese e vuajtjes së dënimit është kryer në shtetin anglez prej 9 vjet. Sjellja dhe qëndrimi i të dënuarit në shtetin e huaj ku ka vuajtur dhe pjesën më të madhe të dënimit nuk rezulton të jetë kërkuar të verifikohet nga ana e magjistratit Bujar Memia dhe as nga vetë gjykata, me anë të akteve të marra zyrtarisht nga ana saj nëpërmjet letërporosisë në kundërshtim me parashikimet e nenit 509 të K.Pr.Penale si dhe nenin 152 të K.Pr.Penale, por është mjaftuar me të dhënat e paraqitura nga pala kërkuese të noterizuara. Raportet e vlerësimit të I.E.V.P Fushë-Krujë dokumentojnë të dhëna vetëm për periudhën 3 vjeçare të vuajtjes së dënimit në këtë institucion nga i dënuari H.B.

160. Për rrjedhojë vlerësohet se prokurori Bujar Memia nëpërmjet mosparaqitjes së kërkesave në gjykim për marrjen e akteve të kësaj natyre pranë autoriteteve të huaja, nuk ka përmbushur

funksinin e vet gjatë gjykimit atë të paraqitjes së kërkesave për marrje prove sipas nenin 356 të K.Pr.Penale, si dhe nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit për mos marrjen edhe kryesisht të këtyre akteve nga ana e gjykatës.

**161.** Prokurori me qëndrimin e vet në seancë dhe me mos ankimin e vendimit, rezulton të ketë bërë një konstatim formal të arsyeve të lirimimit me kusht si koha e vuajtur e dënimit, mungesa e të qenit i dënuar për vepra të tjera penale, respektimi i rregullores dhe mungesa e masave disiplinore, ndërsa ka vlerësuar si arsye të veçantë për lirimimin e tij gjendjen shëndetësore të prindërve si dhe rekomandimin e raportit të vlerësimit nga shërbimi i provës. I njëjti formalitet është vërehet edhe në vendimmarrjen e gjykatës.

**162.** Prokurori në parashtrimet e veta ka theksuar se nisur nga bindja e tij edhe sikur i ndjeri H.B., të vuante 25 vite pa asnjë amnisti, apo pa iu zbritur asnjë ditë nga dënimi 25 vjeçar, përsëri ngjarja e vrasjes së tij do të ndodhte dhe kjo nuk ka të bëjë me veprimet e përfaqësuesit të organit të akuzës apo gjykatës, por me bindjen dhe vullnetin e palës që ka kryer aktin fatal ndaj H.B. Këto parashtrime qëndrojnë në logjikën e përdorur, ndërsa referuar ngjarjes fatale, qëndron po ashtu konstatimi se pikërisht në këtë kontekst nga ana magjistratit Bujar Memia nuk janë vlerësuar drejt arsyet e veçanta të parashikuara në vendimin unifikues Nr. 2/2015, sikundërse janë qëndrimi i të dënuarit ndaj viktimës apo familjarëve të viktimës. Në këtë gjykim nuk është hetuar në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve me viktimën apo familjarë të tij, apo tentative e të dënuarit për të kërkuar faljen dhe normalizimin e këtyre marrëdhënieve, si dhe zëvendësimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose ndihma aktive për të zhdukur apo pakësuar pasojat e veprës penale. Edhe jurisprudenca G.J.E.D.NJ përcakton se kërkohet një nivel edhe më i lartë i verifikimit të raporteve të të dënuarit me të afërmit e viktimës<sup>18</sup>.


**163.** Shkeljet e sipërcituara, të cilat vinë si rezultat i mosveprimit, janë mos përmbushje të detyrave funksionale të prokurorit.

**164.** Në analizë të kriterit **“shkalla e fajësisë dhe motivi”** në raport me faktet e provuara në këtë procedim disiplinor paraprakisht vlerësohet se faji si element i domosdoshëm i përgjegjësisë disiplinore përmban në vetvete dy momente: atë *intelektual* dhe atë që lidhet me *vullnetin*. Momenti intelektual tregon nëse magjistrati subjekt i hetimit disiplinor nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte nëse veprimi/mosveprimi përbën në vetvete shkelje disiplinore, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim që përbën në vetvete shkelje disiplinore dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës.

**165.** Faji si një element i përgjegjësisë disiplinore duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të magjistratit ndaj kryerjes së shkeljes disiplinore si dhe pasojave të ardhura në lidhje me këtë shkelje disiplinore, nuk mund të provohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me prova dokumentare. Për të përcaktuar praninë (*ekzistencën*) dhe formën (*shkallën*) e fajit duhet të analizohen rast pas rasti rrethanat të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljes disiplinore.

**166.** Në të katër çështjet që u përkasin vendimeve me nr. 65 akti, datë 06.11.2017, 82 akti, datë 14.02.2018, nr. 463 akti, datë 21.11.2018 dhe, 26 akti, datë 22.02.2019 rezulton se shkelja disiplinore e mos përmbushjes së pajustificuar të funksioneve gjatë gjykimit, parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “ç” e Ligjit nr. 96/2016, është e përsëritur.

<sup>18</sup> Shiko çështjen Murray kundër Holandës, paragrafi 8.8 “Gjykata më tej merr në konsideratë pozicionin e të afërmit të viktimës. Është vërtetuar mjaftueshëm që lirimi me kusht në të ardhmen do të sjellë pasojat e pa favorshme psikologjike për ta”



167. Nga ana e ILD-së krahas provave të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi kryerjen e shkeljeve disiplinore të analizuara më lart, janë administruar edhe prova të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore apo kriminale të magjistratit, si dhe praktikën e ndjekur nga ana e tij duke administruar të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata me objekt: “Njohje paraburgimi”, “Përfitim amnistie” për periudhën kohore 01.01.2017-01.07.2020 në të cilat ka qenë pjesëmarrës prokurori Bujar Memia.

168. Në analizë të përmbajtjes së vendimeve me objekt “Llogaritje kohe paraburgimi” sipas nenit 57 të K.Penal për periudhën kohore 01.01.2017- 01.07.2020, me pjesëmarrje të prokurorit Bujar Memia rezulton se në këtë periudhë janë dhënë 9 vendime me pjesëmarrje të tij, nga të cilat në 4 raste rezulton se shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102, pika 1, shkronjat ‘ç’, ‘dh’ janë të përsëritura<sup>19</sup>.

169. Në të 4 rastet e konstatuara, megjithëse nga ana e gjykatës është aplikuar neni 57 i K.Penal duke llogaritur si periudhë paraburgimi periudhën nga koha e arrestimit të të dënuarve në shtetin e huaj deri në kohën që vendimi i dhënë nga gjykata shqiptare, për njohjen e vendimit penal të huaj, kanë marrë formë të prerë, në një kohë që përcaktimi i nenit 514 të K.Pr.Penale është i qartë edhe me vendimin unifikues nr.154/2000 të Gjykatës së Lartë, magjistrati nën hetim disiplinor në të katër rastet ka mbajtur të njëjtin qëndrim pasiv në seancë “**në çmim të gjykatës**” dhe për pasojë nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit duke mospërbushur funksionin e vet gjatë gjykimit, atë të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale dhe duke sjellë përfitim të padrejtë për kërkuesit. Në këtë mënyrë prokurori ka cenuar parimin e ushtrimit të funksionit bazuar në parimin e ligjshmërisë dhe të paanshmërisë.

170. Në analizë të përmbajtjes së vendimeve të dhëna me objekt “Përfitim amnistie” sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, për periudhën kohore 01.01.2017-01.07.2020 magjistrati nën hetim disiplinor ka qenë pjesëmarrës në dhënien e 24 vendimeve gjyqësore me këtë objekt, nga të cilat 7 janë pranuar<sup>20</sup>, 3 vendime janë rrëzuar<sup>21</sup>, 13 janë shpallur i papranueshëm për shkak heqje dorë të kërkuesit dhe 1 është vendosur moskompetencë.

171. Nga vendimet e administruara në dosjen hetimore, është konstatuar se vetëm në një rast, në të cilin gjykata ka verifikuar vërtetimin e ekzistencës së kriterit ndalues të parashikuar në nenin 4 të Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie” referuar llojit të veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi, duke disponuar me rrëzimin e kërkesës, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga kontrolli gjyqësor nga gjykata më e lartë. Pjesëmarrës në këtë gjykim ka qenë sërish magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia. Vendimi i rrëzimit të kërkesës, me nr. 675 akti, datë 28.12.2018, është dhënë rreth 1 muaj pas vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 me kërkues H.B, në ndryshim të praktikës gjyqësore në drejtim të kontrollit të kriterëve ndalues të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, duke mos aplikuar nenin 5 të këtij ligji sikundërse ka ndodhur në rastin e kërkuesit H.B.

172. Ky vendim pas kontrollit nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 385, datë 18.03.2019, është lënë në fuqi duke u konfirmuar fakti i mospërfitimit nga amnistia sipas këtij ligji referuar parashikimeve të nenit 5, i cili në çdo rast parashikon si kriter përfitimi nëse koha e mbetur nga vuajtja e dënimit është më pak se 1 vit për të dënuarit burra. **Prokurori Bujar Memia në rastin e vendimit nr. 463, datë 21.11.2018 për përfitim amnistie nuk ka ushtruar ankim, ndërsa ka**

<sup>19</sup> Shiko vendimet nr. 732 akti, datë 27.12.2018; vendimi nr. 610 akti, datë 28.12.2018; vendimi nr. 682 akti, datë 05.12.2018; vendimi nr. 812 akti, datë 05.12.2019.

<sup>20</sup> Përfshi vendimin nr. 463, datë 21.11.2018 me kërkues H.B

<sup>21</sup> Vendimi nr. 675 akti, datë 28.12.2018 dhe vendimi nr. 72 akti, datë 29.06.2020 nr. 164 akti, datë 12.03.2019 për shkaqe të tjera

 qenë dakord me vendimin e rrëzimit të kërkesës së dhënë nga gjykata, me vendimin nr. 675 akti, datë 28.12.2018, duke mbajtur qëndrim krejtësisht të kundërt.

173. Në një rast tjetër në të cilin gjykata ka disponuar me rrëzimin kërkesës për përfitim amnistie, në të cilin magjistrati Bujar Memia e ka lënë në çmim të gjykatës kërkesën, rezulton se shkak i rrëzimit është koha e mbetur për të vuajtur e dënimit më tepër se 1 vit (2 vjet 4 muaj dhe 12 ditë), sipas parashikimit të nenit 5/1 të Ligjit nr. 141/2016 “Për përfitim amnistie”<sup>22</sup>. Vihet re se gjykata ka ndryshuar praktikë në këtë rast, ndërsa nuk është ushtruar ankim, që do të thotë se edhe prokurori ka qenë dakord me këtë vendimmarrje të gjykatës për aplikimin e nenit 5 të Ligjit nr. 141/2016, në të kundërt me aplikimin që i është bërë kësaj dispozite në rastin e kërkesit H.B., në vendimin nr. 463, datë 21.11.2018. Nga ana tjetër prokurori Bujar Memia në seancë ka mbajtur qëndrim “në çmim të gjykatës” qëndrim i cili nuk është në pajtim me kriteret lejuese apo ndaluese të nenit 5 të Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”. Ky qëndrim pasiv i prokurorit është në kundërshtim me vetë funksionin që prokurori ka në çështjet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, atë të mbikëqyrjes së tyre, funksione që duhet të përmbushen në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe të udhëhequra nga parimi i ligjshmërisë dhe paanshmërisë.

174. Nga 10 vendime pranimit për përfitim amnistie sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, të dhëna nga gjykata e rrethit gjyqësor Krujë, në të cilat përfaqësues i organit të akuzës ka qenë magjistrati nën hetim disiplinor Bujar Memia konstatohet se shkeljet janë përsëritur në 7 raste nga ana e magjistratit, në të cilat megjithëse vepra penale për të cilën ishin dënuar kërkesit parashikohej si kriter ndalues për përfitim amnistie sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, dhe gjykata ka disponuar me uljen e dënimit për secilin kërkuar me 1 vit burgim, në kundërshtim me Ligjin nr. 141/2016, magjistrati Bujar Memia gjatë seancave gjyqësore e ka lënë kërkesën në çmim të gjykatës, ndërsa nuk ka ushtruar ankim në asnjë prej këtyre rasteve, duke sjellë përfitim të padrejtë me 1 vit burgim për secilin prej të dënuarve<sup>23</sup>. Konstatohet se sjellja pasive është si gjatë seancës gjyqësore me qëndrimin e mbajtur ashtu dhe me mungesën e kryerjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës.

175. Në analizë të të dhënave profesionale, të çështjeve disiplinore apo kriminale të magjistratit rezulton se magjistrati ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2006, dhe ka një përvojë të gjatë në sistemin gjyqësor prej 14 vite të plota si dhe vlerësimet e tij profesionale “të mira” vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016<sup>24</sup>, tregojnë qartë se veprimet/mosveprimet e magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbëjnë shkelje disiplinore dhe nuk lidhen me veprimtarinë e tij profesionale të cilat të mund të shërbejnë vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të tij.


176. Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë procedimit disiplinor rezulton se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit në çështjet objekt hetimi, nuk janë kryer në kuadër të paaftësisë së tij profesionale, por si rezultat i veprimeve të kryera me pakujdesi të rëndë nga ana e tij.

177. Për sa më sipër, në analizë të rrethanave të kryerjes së shkeljes disiplinore rezulton se:

<sup>22</sup> Vendimi nr. 72 datë 29.06.2020

<sup>23</sup> Vendimi nr. 885 akti, datë 20.12.2019 me kërkuar T.N; vendimi nr. 706 akti, datë 16.12.2019 me kërkuar E.S; vendimi nr. 615 akti, datë 03.10.2019 me kërkuar E.C; vendimi nr. 417 akti, datë 20.06.2019 me kërkuar B.L; vendimi nr. 349 akti, datë 15.05.2019 me kërkuar R.T; vendimi nr. 279 akti, datë 17.04.2019 me kërkuar A.B, vendimi nr. 4/691, datë 27.01.2020 me kërkuar Y.B

<sup>24</sup> Referuar dosjes personale te magjistratit



(i) nga ana e magjistratit subjekt i procedimit disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjmë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, duke mos respektuar parashikimet e nenit 57, 59/a, pika 1, shkronja “c”, 64, të Kodit Penal, nenit 17, 18, 149, 152, 178, 366, 438, 514, 518 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, neni 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, neni 61, pika 2, të Ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, si dhe parashikimet e vendimeve nr. 154/200 dhe nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë;

(ii) nuk është kërkuar marrja e provave vendimtare për zgjidhjen e çështjes, nuk është kërkuar marrja e saj kryesisht nga gjykata dhe nuk është ushtruar ankim ndaj vendimit pavarësisht mungesës së marrjes së një prove të tillë kryesisht nga gjykata duke mos përmbushur funksionet e veta gjatë gjykimit në ligjshmëri dhe paanësi të prokurorit në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale;

(iii) nuk janë respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kritere me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme për lirim të dënuarit, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistratit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita;

(iv) njohja e cilësisë së dhënë nga gjykata si i paraburgosur të të dënuarit për një periudhë gjatë të cilës ai ka pasur cilësinë e të dënuarit në kundërshtim me parashikimet ligjore neni 57 i K.Penal dhe neni 514 i K.Pr.Penale;

(v) mos mbajtja e një qëndrimi ligjor gjatë gjykimit të lirit me kusht të të dënuarit, megjithëse mori dijeni në këtë gjykim mbi një vendim të dhënë nga e njëjta gjykatë e cila, në shkelje të ligjit, i kishte ulur dënimin të njëjtit të dënuar, në masën prej 90 ditë, në funksion të pranimit të çdo kërkesë të paraqitur nga ana e tij, të cilat sollën dhe rritje fiktive të periudhës së dënimit të llogaritur për efekt lirim;

(vi) mos mbajtja e një qëndrimi ligjor gjatë gjykimit të lirit me kusht të të dënuarit, megjithëse mori dijeni në këtë gjykim mbi dy vendime të dhëna nga e njëjta gjykatë e cila, gjatë periudhave të njëjta i ka njohur të dënuarit dy cilësi: si i paraburgosur dhe si i dënuar, në funksion të pranimit të çdo kërkesë të paraqitur nga ana e tij, të cilat sollën dhe rritje fiktive të periudhës së dënimit të llogaritur për efekt lirim;

(vii) mosrespektimi i kriterëve ndalues për përfitim amnistie sipas Ligjit nr. 141/2016 në ndryshim nga praktika e ndjekur gjatë trajtimit të kërkesës, me objekt “Përfitim amnistie” në vitin 2017 në çështjen me nr. 217 akti;

(viii) qëndrimet e prokurorit në këto gjykime për pranim kërkesë apo lënien e tyre në çmim të gjykatës;


(ix) mos ankimi i vendimeve gjyqësore duke pas sjellë pamundësinë e ushtrimit të kontrollit gjyqësor të vendimeve të dhëna në kundërshtim me ligjin. Këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar në 3 procese gjyqësore me të njëjtin kërkuar H.B, dhe në 1 proces tjetër me kërkuar I.P. Qëndrimi i prokurorit në këto seanca për pranim kërkesë apo lënien e tyre në çmim të gjykatës, dhe mos ushtrimi i ankimeve gjyqësore. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se shkeljet disiplinore janë kryer nga ana e magjistratit Bujar Memia me pakujdesi të rëndë, janë të tilla që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit.



178. Ndërsa në analizë të kriterit “**pasojë e shkeljes**” asaj të mos përmbushjes të funksionit gjatë gjykimit, në dakordësinë e magjistratit me vendimin për aplikim dënimi alternativ ndaj të dënuarit I.P., rezulton se si pasojë e veprimeve/mosveprimeve të kryera nga ana e magjistratit Bujar Memia si përfaqësues i organit publik, i cili përfaqëson interesin publik në gjykim, është cenuar parimi i ligjshmërisë dhe i paanësisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit dhe i besimit të publikut tek drejtësia, duke u liruar një i dënuar për shkaqe shëndetësore pa u kërkuar dhe pa u marrë një provë vendimtare në funksion të provueshmërisë së shkakut të aplikimit të dënimit alternativ, në funksion të dhënies së drejtësisë. Si pasojë edhe e veprimeve të kryera nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor në rastin e kërkesave të të dënuarit H.B., është liruar një i dënuar i rrezikshëm, i cili përbën rrezik për komunitetin si dhe shoqërinë në përgjithësi. Kryerja e veprimeve/mosveprimeve të para si një sjellje në tërësinë e vet nga ana e magjistratit Bujar Memia ka cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin (*ratio*) e institutit të lirit me kusht të parashikuar nga norma penale. Parashikimi i kërkesave apo kushteve është një garanci për funksionet e dënimit dhe natyrisht duke mos u sakrifikuar objektivi kryesor që është siguria e komunitetit ndaj personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, por dhe për të mos nxitur hakmarrjen ndaj personave të liruar. Është fakt i njohur se shtetasi i liruar H.B është ekzekutuar në datë 11.06.2020. Kjo e fundit provon gjithashtu se nga ana e magjistratit nuk është vlerësuar drejt kriteri i përcaktuar edhe në vendimin unifikues nr. 2/2015 mbi arsyet e veçanta për lirin me kusht, sikundërse është qëndrimi dhe marrëdhënia e të dënuarit me viktimën apo familjarë të tij. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet veprimeve veprimeve/mosveprimeve të kryera nga ana e magjistratit është sjellë një përfitim i padrejtë për të dënuarin H.B në kundërshtim me ligjin, e cila është pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljes disiplinore.

179. Në analizë të kriterit “**masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore**” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt hetimi disiplinor nuk është shtrirë vetëm tek magjistrati subjekt i hetimit disiplinor por ka krijuar terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme. Standardet e gabuara të qëndrimeve pasive të prokurorit ndaj vendimeve gjyqësore të kësaj natyre të Gjykatës së Rrethit Krujë, mund të aplikohen edhe nga magjistratë të tjerë si dhe njëkohësisht mund të shërbejë si praktikë për edhe shumë të dënuar të tjerë me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore të pretendojnë në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit penal në fuqi për lirin para kohe të tyre me kusht, përfitim amnistie, llogaritje kohe paraburgimi gjatë periudhës së qenies të dënuar, apo aplikimet alternative të dënimit pa marrë provat thelbësore në proces.

180. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore; (ii) rrethanat e shkeljes së kryer të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal; (iii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; (iv) përvojën e gjatë të magjistratit në sistemin gjyqësor, si dhe vlerësimet e tij të mira profesionale; (v) pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me lirin e një të dënuari të rrezikshëm i cili përbën rrezik për komunitetin dhe shoqërinë në kundërshtim me parashikimet legjislacionit material dhe procedural penal, dhe shmangien e kontrollit gjyqësor të vendimit nga një gjykatë më e lartë dhe krijimi i mundësisë për hakmarrje ndaj tij; (vi) cenimin e imazhit të sistemit të prokurorisë si përfaqësues i interesit publik në gjykim, dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; (vii) ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme; (viii), përsëritja e shkeljeve në rastet e cituara në Raport, si (viii) mungesën ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Bujar Memia, nëse i referohemi Ligjit për Statusin pas



ndryshimeve, do të konsideroheshin shkelje disiplinore sipas 101, neni 102 pika 1 shkronjat “ç” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a” të Ligjit për Statusin, të cilat në rastin konkret përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”. **Pra shkeljet disiplinore të sipërcituara, sipas përcaktimeve të ligjit për statusin (pas ndryshimeve), kualifikohen si shkelje shumë të rënda, pra në të njëjtin nivel me shkeljen e parashikuar nga neni 148/d i Kushtetutës.**

**181.**Në analizë të çështjes lidhur me **llojin e masës së disiplinore** paraprakisht vlerësohet të theksohet se qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.


**182.**Ndërkohë, në rastin kur shkelja disiplinore e kryer është aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore merr përsipër të mbrojë interesin publik, duke larguar nga detyra magjistratin dhe duke u kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj tij. Pikërisht ky është rasti i parashikuar në nenin 148/d, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit prokurori shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

**183.**Në rastin konkret për sa është analizuar më sipër, është arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Bujar Memia në kuptim të nenit 148/d, pika 2, të Kushtetutës, përbëjnë “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”.

**184.**Në këto kushte, në rastin konkret duhet të analizohet fakti nëse veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Bujar Memia që përbëjnë “*Shkelje shumë e rëndë disiplinore*” përbëjnë “*akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit*” gjatë ushtrimit të detyrës dhe për rrjedhojë e bëjnë atë të pa përshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij si magjistrat. Veprimet apo mosveprimet e prokurorit që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve<sup>25</sup>.

**185.**Koncepti i shkeljeve të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit prokuror është i ri në Kushtetutë, ndërsa ky koncept për magjistratin gjyqtar ka qenë parashikuar edhe më parë në Kushtetutë, duke u pasuruar edhe nga jurisprudenca konstante e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vënë në dukje se kjo shprehje, përmbledh në vetvete një sërë elementësh, të cilët mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit

<sup>25</sup> Vendimi Nr. 75/2002, i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi Nr. 3/2006 i Gjykatës Kushtetuese.



duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte<sup>26</sup>. E njëjta analizë vlen edhe në rastin e identifikimit të akteve të cilat diskreditojnë figurën dhe pozitën edhe të prokurorit si përfaqësues i akuzës në gjykim.

**186.** Vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes sanksionuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkojnë që magistratët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën. Shkelja e ligjit nga një magistrat mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si magistrat, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin jo vetëm të prokurorisë por dhe vetë gjyqësorit. Një magistrat është i detyruar të respektojë ligjin dhe ai nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti me zbatimin e ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te magistrati mund të tërheqë vëmendje dhe të dëmtojë imazhin e tij dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e vetë magistratit dhe integritetin e vetë sistemit të drejtësisë.

**187.** Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të gjyqtarëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, organet përgjegjëse duhet të mbajnë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit<sup>27</sup>. Të njëjtat parime, rregulla e vlera janë të detyrueshme për tu ndjekur edhe nga ana e prokurorit i cili vërtet është palë në gjykim, por ai nuk është palë private dhe gjykimet e kësaj natyre nuk janë midis privatëve, por është përfaqësues i interesit publik në gjykim, i cili ka detyrim ligjor të mbikëqyrë me rigozitet dhe në zbatim të plotë të kuadrit kushtetues dhe ligjor vendimet e dënimit të dhëna ndaj të dënuarve, në mënyrë që këto vendime dënimi të kryhen plotësisht nga të dënuarit dhe të mos ketë shmangie nga vuajtja e këtij dënimi për shkak të moszbatimit të ligjit me dashje nga ana e gjykatës. Roli i prokurorit në çështjet e shqyrtimit të kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nuk është formal dhe nuk mund të mjaftohet vetëm me prezencë formale të prokurorit në seancë, por duhet të ketë rol aktiv në mënyrë që të shtrojë para gjykatës të gjitha çështjet e ligjit dhe të faktit, të cilat kanë lidhje me objektin e kërimit. Në vijim të rolit dhe funksionit që ka prokurori në këto çështje, mosdhënia përgjigje nga ana e gjykatës e çështjeve të shtruara për trajtim nga ana e prokurorit, ose në mungesë të tyre dhënia e një vendimi në shkelje të ligjit penal material dhe procedural apo dhe i ligjit të posaçëm, do të përbënte shkak edhe për ankimimin e tij me qëllim kontrollin e vendimmarrjes së gjykatës nga një gjykatë më e lartë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në asnjë prej 4 rasteve objekt procedimi disiplinor të analizuar më lart.

**188.** Referuar parashikimeve të trajtuara më sipër kuptohet dhe del qartë rëndësia e madhe që ka respektimi i normave ligjore nga ana e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Kjo rëndësi del qartë dhe nga fakti se pikërisht shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të këtyre normave, kur kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve ose për dhënien e drejtësisë, konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit.

**189.** Në mbështetje të nenit 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, një ndër vlerat themelore të deklaruara është pavarësia e magistratit. Pavarësia në ushtrimin e funksioneve të prokurorit i referohet pavarësisë së brendshme dhe të jashtme. Pavarësia e brendshme lidhet me pavarësinë e çdo individi magistrat për të ushtruar funksionet që lidhen me pozicionin e tyre. Ky parim parashikohet edhe në nenin

<sup>26</sup> Shih për më tepër vendimin Nr.11/2004, të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>27</sup> Vendimi Nr. 11/2004, i Gjykatës Kushtetuese

148, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me pavarësinë e prokurorisë që si organ që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj, dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorit për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e prokurorëve për kontrollin e zgjidhjes së çështjeve konkrete nga ana e gjykatave me anë të mjetit procedural të ankimit.

190. Magjistrati e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur, por ai nuk mund të veprojë në mënyrë arbitrare dhe të gjykojë rastet duke u bazuar në preferencat personale, interesi vetjak apo keqbesimi, por vetëm duke u bazuar në ligjet përkatëse dhe duke i interpretuar ato në varësi të rrethanave të veçanta të një çështjeje. Elementi i bindjes së brendshme të magjistratëve është i lidhur vetëm me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve të një çështjeje të caktuar. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta. Magjistrati mban përgjegjësi sipas ligjit dhe një qasje e tillë është në përputhje me parashikimet e nenit 148/d, të Kushtetutës.

191. Interpretimi i kësaj shkeljeje disiplinore në frymën e dispozitave kushtetuese, nenit 148/d, pika 2, shkronja “a” nënkupton mungesën e ushtrimit të kompetencës së veçantë të prokurorit për kontrollin e zgjidhjes së çështjeve konkrete nga ana e gjykatave me anë të mjetit procedural të ankimit, sikundërse parashikon neni 148/2 i Kushtetutës.

192. Në rastin e magjistratit Bujar Memia me qëndrimet e mbajtura, mosveprimet dhe mungesa e ankimit prej tij të vendimeve të dhëna: (i) Vendimi nr. 65, datë 06.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (ii) Vendimi nr. 82 akti, datë 14.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (iii) Vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; (iv) Vendimi Nr. 26, datë 22.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke mos u kontrolluar zgjidhja e çështjeve të mësipërme nga ana e gjykatave, përbëjnë akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit. Në rastin konkret qëndrimi i prokurorit ka qenë tërësisht i njëanshëm dhe në kundërshtim flagrant me dispozitat materiale dhe procedurale penale dhe ligjet specifike.

193. Neni 148, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se: “Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit”.

194. Neni 6 i Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon pavarësinë e prokurorit dhe parimet të cilat udhëheqin këtë pavarësi “*Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë*”.

195. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e prokurorëve për kontrollin e zgjidhjes së çështjeve konkrete nga ana e gjykatave me anë të mjetit procedural të ankimit. Nga ana tjetër prokurorët kanë detyrim që ushtrimin e detyrës së tyre ta kryejnë në përputhje me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet e tjera në fuqi. Neni 4 i Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “*Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik*”.

196. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e vet ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku

dhe mbi të gjitha, te palët në proces. Për këtë qëllim neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Edhe për prokurorin vlen i njëjti parim, ai i paanshmërisë për shkak të mbrojtjes edhe të interesit publik në këto çështje. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimëve nga magjistrati për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur<sup>28</sup>. Një prokuror duhet të jetë i paanshëm jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur, ndërsa shprehjet e natyrës “në çmim të gjykatës” nuk udhëhiqen aspak nga ky parim. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet.

**197.** Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon magjistrati për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për qëndrim të paanshëm nga vetë prokurori, përmes mënjanimit prej tij të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim<sup>29</sup>. Kjo realizohet vetëm nëpërmjet ezaurimit të gjithë hetimit gjyqësor për çështjen e lidhur drejtpërsëdrejti me rolin aktiv të prokurorit në ushtrimin e funksionit të tij sikundërse është paraqitja e kërkesave për prova në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe kontrolli i një zgjidhje të drejtë të çështjes dhe dhënia drejtësi nga ana e gjykatës.

**198.** G.J.E.D.N.J në jurisprudencën e vet ka pohuar se: “Fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor e lidhur me testin objektiv<sup>30</sup>. G.J.E.D.N.J në jurisprudencën e vet bën një dallim midis: (i) një kriteri subjektiv, domethënë duke kërkuar për të përcaktuar bindjen personale të këtij apo atij gjyqtari në një çështje të caktuar; dhe (ii) një kriteri objektiv, domethënë duke përcaktuar nëse gjyqtari ofronte garanci të mjaftueshme për të përjashtuar në këtë drejtim çdo lloj dyshimi të drejtë. Kufiri ndërmjet këtyre dy koncepteve nuk është hermetik, sepse përveç që vetë sjellja e gjyqtarit ka mundësi që, nga këndvështrimi i një vëzhguesi të jashtëm, të ngjallë dyshime objektivisht të përligjura për sa i përket paanshmërisë së tij (kriter objektiv), ajo mund të prekë gjithashtu edhe pikën lidhur me bindjen e tij personale (kriter subjektiv). Për këtë arsye, zbatueshmëria e njërit kriter apo e tjetrit, ose e të dyve së bashku, do të varet nga rrethanat e veçanta të sjelljes së kundërshtuar<sup>31</sup>. Edhe në rastin e prokurorit janë pikërisht këto kritere të cilat merren në analizë rreth paanshmërisë së tij në gjykimet e çështjeve të kësaj natyre.

**199.** Në rastin konkret objekt hetimi disiplinor rezultoi se gjatë dhënies së vendimit nr. 65, datë 06.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, magjistrati Bujar Memia sikundërse dhe gjykata ka marrë të mirëqenë plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 59/a pika 1 shkronja “c” e Kodit Penal duke u bazuar në të dhëna dhe indicje mbi gjendjen shëndetësore të të dënuarit të cilat jo vetëm që nuk janë kategorike, por nuk janë dhënë nga ekspertë të fushës. Prokurori nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për marrje prove me ekspert për zgjidhjen e çështjes. Gjykata ka konkluduar për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, pa hetuar provueshmërinë e kushteve që parashikon shkronja “c”, e pikës 1 të nenit 59/a të Kodit Penal, me marrjen e provës vendimtare që kërkon natyra e gjykimin, duke krijuar perceptimin e njëanshmërisë së gjykatës në gjykim, dhe prokurori Bujar Menia, nuk i ka kërkuar gjykatës ta administrojë kryesisht këtë provë si dhe nuk

<sup>28</sup> Shiko vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30/2005;23/2007; 24/2007; 28/2007;42/2007; 25/2011

<sup>29</sup> Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 38/2007

<sup>30</sup> Shiko Delage and Magistrello kundër Francës, nr. 40028/98, ECHR 2002II.

<sup>31</sup> Shiko Kyprianou k. Qipros.

ka ushtruar ankim për të kontrolluar gjykata më e lartë provueshmërinë e kriterëve të parashikuara nga neni 59/a, shkronja “c” e Kodit Penal nga gjykata më e ulët, duke krijuar perceptimin e njëanshmërisë së tij në gjykim.

**200.** Nga tërësia e fakteve të konstatuara nisur nga: (i) numri dhe lloji i kërkesave të paraqitura nga i dënuari me objekt: 1 kërkesë me objekt “Lirim për shkak sëmundje” dhe 2 kërkesa me objekt aplikim dënimi alternativ “Qëndrim në shtëpi” nga të cilat, 2 kërkesa i kanë kaluar fillimisht për gjykim gjyqtarës tjetër E.T. e cila gjatë gjykimit të kërkesës për lirimin e të dënuarit për shkak sëmundje, mori vendim për caktim ekspertësh mjeko-ligjorë, dhe 1 kërkesë me gjeneralitete jo të sakta të kërkesit, por të ngjashme me to, e cila i kaloi gjykim magjstrates Enkeleida Hoxha; (ii) koha e shkurtër e paraqitjes së kërkesës me gjeneralitetet jo të sakta të kërkesit pas vetëm 1 jave nga shortimi i kërkesës së parë tek gjyqtarja E.T; (iii) fakti se në të dy kërkesat në proces shqyrtimi pranë gjyqtarës E. T, kërkesi është tërhequr nga gjykimi, duke tentuar madje në një rast edhe përjashtimin e saj menjëherë sapo gjyqtarja vendosi kryerjen e aktit të ekspertimit mjeko - ligjor; (iv) mosparaqitjen e kërkesave procedurale nga prokurori për marrjen e provës vendimtare nga ana e gjykatës atë të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor për zgjidhjen e çështjes ndërsa u dha akteve të paraqitura nga kërkesi I.P vlerë të paracaktuar, duke siguruar pritshmëritë e kërkesit si në drejtim të moskryerjes së aktit të ekspertimit mjeko-ligjor ashtu dhe aplikimin e dënimit alternativ; (v), mosparaqitja e ankimit ndaj një vendimi i cili nuk u bazua në prova të dhëna mbi bazë vlerësimi të indicjeve nga ekspertë të fushës, duke sjellë nxjerrjen nga regjimi i burgut, provon mosplotësimin e kriterit objektiv të paanshmërisë së magjstrates Bujar Memia në gjykimin e çështjes me nr. 65 akti, datë 06.11.2017 dhe për rrjedhojë mos përmbushjen e funksioneve të prokurorit në drejtim të cenimit e parimit të paanësisë së tij në gjykim e lidhur kjo dhe me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe alternativave të dënimit.

**201.** Sjellja në vijimësi e magjstratit Bujar Memia mbi kërkesat e të dënuarit H.B, duke u shprehur për lënien në çmim të gjykatës të dy kërkesave (ajo për llogaritje kohe paraburgimi dhe përfitim nga amnistia) dhe dakordësia e aplikimit të lirimimit me kusht tek çështja tjetër, si dhe mos ushtrimi i ankimit për të 3 rastet<sup>32</sup> në kundërshtim me ligjin dhe në shkelje flagrante të tij, duke sjellë edhe lirimin e të dënuarit H.B nga burgimi, i cili nga një vendim fillestar me burgim të përjetshëm nga autoriteti i huaj gjyqësor, pas njohjes së tij me 25 vite burgim, përfundoi duke vuajtur në shtetin shqiptar vetëm 3 vite burgim në një kohë që pas dhënies së vendimit të njohjes nr.1016/2016, i kishin mbetur për të vuajtur edhe 16 vite 4 muaj referuar urdhrin të ekzekutimit të prokurorit, përmbajtja e të cilit u shpërfill nga ana e prokurorit Bujar Memia, provon mungesën e kriterit objektiv të paanshmërisë dhe ligjshmërisë në gjykim si dhe diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e prokurorit si brenda vendit ashtu edhe në marrëdhënie me autoritetet gjyqësore të huaja, vendimet e të cilave njihen dhe ekzekutohen në shtetin shqiptar.

**202.** Për sa sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjstratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke

<sup>32</sup> Një kërkesë tjetër e pranuar nga gjyqtarja rezulton të jetë dhënë në zbatim të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, përsëritja e shkeljeve disiplinore, paraprakisht vlerësohet se për veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Bujar Memia, parashikohen si shkelje, nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përbëjnë "Shkelje shumë e rëndë disiplinore", që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të jepet masa disiplinore "Shkarkim nga detyra", e parashikuar nga neni 148/d, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 148/d, pika 2 germa "a", nenin 149/a pika 1 germa "b", 179 pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 146, 148 pika 2, germa "c", neni 149 pika 1, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve", i ndryshuar, nenin 184 germa "e", neni 189 pika 1, germa "a", neni 192 paragrafi 1 fjalia e dytë, të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, nenin 104 të Kodit të Procedurës Administrative së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin Nr.260, datë 17.11.2020 të KLP-së, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

### V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr.104 prot., datë 15.01.2021, për procedim disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia.
- Shkarkimin nga detyra të magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.
- Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. Bujar Memia brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
- Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA




VIA-AL

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI



ANËTAR  
BUJAR SHESHI



Kundësi

ANËTAR  
NURIHAN SEITI




ANËTAR  
ELOIDA GOXHI



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI




ANËTAR  
MOISI DUDA



ANËTAR  
VATË STAKAJ



ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

